KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME- SHKUP
ФАКУЛТЕТ ЗА ИСЛАМСКИ НАУКИ - СКОПЈЕ
FACULTY OF ISLAMIC SCIENCES – SKOPJE

LIBRI I PUNIMEVE SHKENCORE TË KONFERENCËS

MULTIKONFESIONALIZMI NË SHOQËRINË MULTIETNIKE DHE MULTIKONFESIONALE NË RMV

Shkup, 25 korrik 2020

Mbështetur nga:

Република Северна Македонија
Министерство за култура

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Kulturës

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

LIBRI i punimeve shkencore të konferencës : multikonfesionalizmi në shoqërinë multietnike dhe multikonfesionale në RMV / Shaban Sulejmani. - Shkup : Fakulteti i shkencave islame, 2020. - 92 стр. ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-9989-2011-9-6

а) Мултикултураклни општества -- Етнички основи -- Исламски аспекти -- Македонија б) Меѓуетнички односи -- Толеранција -- Македонија в) Религија -- Толеранција -- Македонија

COBISS.MK-ID 52456965

Fjalë rasti

Të nderuar pjesëmarrës në konferencë më lejoni ta shpall të hapur këtë konferencë me titull Multikonfesionalizmi në shoqërinë multietnike dhe multikonfesionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Konferenca ishte planifikuar të mbahet në lokalet e FSHI-së, por për shkak të situatës me pandeminë jemi të detyruar ta mbajmë online.

Të nderuar pjesëmarrës mirë se vini në FSHI, ku disa nga ju keni njohuri për FSHI-në RMV, u ky fakultet mision të vetin ka krijimin, përcjelljen, mbrojtjen e dijeve, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbimeve dhe formimit të specialistëve të lartë në fushat e studimeve islame, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Vizioni ynë është të ndërtojmë një fakultet modern, të fokusuar drejt së ardhmes, të vlefshëm për shoqërinë tonë multietnike dhe multifetare, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend, si edhe në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal. Prandaj, uroj që lirshëm të këmbeni mendime dhe ide të argumentuara shkencore për një temë shumë të rëndësishme siç janë multikonfesionalizmi dhe multikulturalizmi, të cilët janë dhe mbeten pasuri dhe mbështetje për njëra-tjetrën dhe e bëjnë të veçantë një shoqëri, prandaj kjo pasuri duhet të kultivohet edhe në të ardhmen.

Islami dhe Krishterimi, dy nga fetë më të mëdha të trashëgimisë abrahamike, kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në qytetërimin njerëzor. Prandaj, angazhimi i komunitetit fetar islam këtu në RMV ka promovuar një angazhim të përbashkët ndaj vlerave universale të

drejtësisë sociale, barazisë, të mirës së përbashkët, mirëqenies sociale, pjesëmarrjes politike, lirisë fetare dhe një mori parimesh e vlerash të tjera të përbashkëta. Duke pasur parasysh klimën politike dhe shoqërore moderne në botë, është më e rëndësishme se kurrë më parë të diskutohet mbi kontributet e qytetërimeve, me qëllim të ndërtimit të urave të vlerësimit dhe mirëkuptimit midis popujve të kulturave dhe ideologjive të ndryshme. Për të sjellë paqe të sinqertë në këto hapësira, ne duhet të ringjallim pastërtinë e pacenuar dhe frymën e barazisë monoteiste dhe të drejtësisë për të gjithë. Duhet të sigurohemi që këto vlera shpirtërore të kthehen në fuqi për t'i sjellë njerëzit në kuptimet e tyre.

Edhe njëherë, uroj të kaloni mirë në këtë konferencë, të njihemi në mes veti, të këmbejmë ide e mendime të argumentuara shkencërisht, por edhe të hapim rrugë bashkëpunimit tonë në hapësirat ballkanike, evropiane e botërore.

Ju faleminderit!

Assoc. Prof. Dr.sc. Shaban Sulejmani
Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame

CONFERENCE CHAIR

Assoc. Prof. Dr.sc. Shaban Sulejmani
Dean of the Faculty of Islamic Sciences – Skopje

SECRETARY OF THE CONFERENCE

Ass. Prof.Dr.sc. Muaz Agushi

SCIENTIFIC COMMITTEE

Assoc. Prof. Dr.sc. Abdulxhemil Nesimi

Assoc. Prof. Dr.sc. Hasan Xhilo

Assoc. Prof. Dr.sc. Muhamed Mustafa

Assoc. Prof. Dr.sc. Naser Ramadani

Assoc. Prof. Dr.sc. Shaban Sulejmani

Prof. Dr. Gjoko Gjorgjevski

Prof. Dr. Konstantin Minovski

ORGANIZING COMMITTEE

Assoc. Prof. Dr.sc. Ismet Osmani

Assoc. Prof. Dr.sc. Florim Idrizi

PËRMBAJTJA

MULTIKONFESIONALIZMI DHE RAPORTET MIDIS BASHKËSIVE FETARE **Abdulxhemil NESIMI**..... 6

A MUNDET MODELI ISLAM I TOLERANCËS, MILTIKULTURALIZMIT, E MULTIFETARIZMIT TË BËHET ALTERNATIVË E DEMOKRACISË?
Fadil MALOKU 19

RËNDËSIA E TOLERANCËS FETARE NË SHOQËRITË MULTIKONFESIONALE DHE MULTIETNIKE
Fahrush REXHEPI 50

ROLI I GJUHËS NË SHOQËRINË MULTIKONFESIONALE
Muhamed MUSTAFI..... 59

MULTIKONFESIONALIZMI NË SHOQËRINË MULTIETNIKE NË RMV **Shaban SULEJMANI** 69

ЕВРОПСКОТО ИСКУСТВО СО РЕЛИГИСКАТА ЕДУКАЦИЈА
Ѓоко ЃОРЃЕВСКИ..... 77

MULTIKONFESIONALIZMI DHE RAPORTET MIDIS BASHKËSIVE FETARE

Abdulxhemil NESIMI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup, e-mail: abdulxhemil.nesimi@fshi.edu.mk

Abstrakt

Diversiteti dhe llojshmëria konsiderohen dukuri nga dukurit e natyrës dhe e universit të cilat i kuptojnë dhe perceptojnë të gjitha qeniet njerëzore. Nëse i hedhim një vështrim soditës natyrës dhe universi i pafund dhe më pas drejtojmë shikimin kah qielli i zbukuruar me yjet e mrekullueshme, të shfaqet një nga faktet më të mëdha objektive që e ndjekin të gjitha trupat qiellor pa përjashtim, ajo është larmia e mahnitshme, qëllimin dhe sekretin përfundimtar është i panjohur përveçse për Krijuesin e qiejve dhe tokës. Nëse shikojmë botën bimore me të gjitha larmitë e saj të mrekullueshme, nga farat e vockla deri tek pemët gjigande tregojnë një botë që është jashtëzakonisht e larmishme, me ngjyra, emra, varietete të ndryshme. Ky diversitet gjithëpërfshirës i të gjitha gjërave është i domosdoshëm për shkak të funksioneve të ndryshme, strukturave të brendshme dhe të jashtme të tyre. Për deri sa ne meditojmë më tepër dhe vështrojmë më largë, realitetet më të mëdha të universit tregojnë se ky diversitet është fenomen kozmik që përfshin hollësitë e botës natyrore dhe të gjithë elementet e tij në manifestime të ndryshme. Për më tepër, ky diversitet nuk ka ndodhur rastësisht, përkundrazi, është nga planifikimi dhe krijimtaria e Krijuesit të qiejve dhe tokës, njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes që ka zotëruar gjithçka në krijimin e tij. Dëshmitë nga Kur'ani dhe Sunneti tregojnë se kjo larmi në çdo gjë është prej mrekullisë dhe krijimtarisë në krijim, që do të thotë se madhështia e Zotit të Madhërishëm nuk manifestohet vetëm në krijimin e gjërave nga asgjë, por në krijimin dhe ekzistimin e tyre.

Ky diversitet bartë meditimin në një diversitet tjetër që ka të bëjë me larminë e prirjeve, besimeve, opinioneve njerëzore, pa u përqëndruar në larminë e tyre në formë, ngjyrë, etni dhe gjuhë, sepse këtu vërejmë dy

nivele të diversitetit: një diversitet që nuk ka asnjë lidhje me besimet fetare, domethënë, larmi shijesh, zakone dhe modele të jetës, veshja dhe gjëra të tjera që lidhen me kulturën në kuptimin e saj të përgjithshëm, që është larmi e jashtëzakonshme që në shumicën e rasteve shton shkëlqimin dhe gëzimin në jetën e njeriut, në atë që është në harmoni me larminë formuese të universit dhe krijesave. Diversiteti tjetër lidhet me sferën e besimeve fetare, bindjet dhe orientimet politike që përfshijnë formulat se si duhet të jetë jeta e njeriut në shoqëri për sa i përket sistemit politik dhe shoqëror, që është aspekt normal i jetës njerëzore, nga ekzistimi i tij deri në ditët e sotme.

Meqenëse nuk ekziston periudh ku bijtë e Ademit të mos kenë qenë të ndryshëm, përkundrazi, ata gjithmonë jetojnë në pluralizëm dhe diversitet të vazhdueshëm. Pra, historia e ekzistencës njerëzore është historia e larmisë në besime, doktrina dhe mendime, si dhe diversitet gjithëpërfshirës në manifestimet e jetës për të gjitha botët, që është në përputhje me qëllimet e krijimit dhe ekzistencës, sepse, nuk erdhi kurrë në kundërshtim me vullnetin e Zotit, përkundrazi, është ligj i Zotit në krijim dhe si i tillë do të vazhdon për deri sa të dëshiron Zoti.

Nisur nga ky realitet, kuptojmë se diversiteti është çështje e natyrshme dhe se çdo qenie njerëzore lind në një mjedis dhe rreth që është i ndryshëm nga të tjerët, në formimin e personalitetit të tij ndikon ambienti, ndërsa variacioni i mendjes funksionon në saj të përpjekjeve që një person arrinë.

Fjalë kyçe: *Islam, multikonfesionalizmi, diversiteti, bashkësi, etni.*

1. Vizioni Islam kufizon ndryshimin në kufijtë konstruktiv

Që në fillim dëshiroj të theksojë një fakt të madh fetar të denjë për soditje. Zoti i Madhëruar nderoi bijtë e Ademit, pavarësisht nga ngjyrat, gjuhët dhe doktrinat fetare dhe intelektuale të tyre, me arsye dhe vullnet të lirë (zgjedhje) dhe aftësinë për të folur gjuhë të ndryshme në mjedise të ndryshme. I Përlavdëruari në Kur'an thotë: *"Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësu am ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam."* (Israë, 70)

Ndërkaq, komentatori i shquar, Ibn Ashur, në lidhje me ajetin në fjalë thotë: "Me bijtë e Ademit nënkupton i gjithë lloji, pasi përshkrimet e konfirmuara këtu janë vetëm dispozita për llojin ashtu siç është."[1]

Nderimi hyjnor i qenies njerëzore është i përfaqësuar në dy çështje themelore:

Çështja e parë: njeriu dallohet nga të gjitha krijesat e tjera me arsyen që është kusht i domosdoshëm i obligimit dhe përgjegjësisë. Në të gjithë religjionet një person nuk mban përgjegjësi përveç se veprimi të buron nga liria dhe vullneti i tij.

Çështja e dytë: preferenca e njeriut ndaj krijesave të tjera, është se Krijuesi ia nënshtroi dhe vendosi në dispozicion për t'i shfrytëzuar mirësitë të cilat i nënshtrohen vullnetit dhe sjelljes së tij.[2]

Krijimi i njeriut i lirë dhe me të drejtë zgjedhje dëshmon se ndryshimi midis njerëzimit është çështje natyrore dhe është në përputhje me natyrën që Zoti i fali njerëzit. Mund të ndodhë që një person të mos pajtohet me qëndrimet e tij, ndodh që një mendim të sodit e demanton të nesirmit. Sidoqoftë, ky ndryshim mund ta çojë një person drejt boshteve të injorancës dhe intolerancës, prirjes drejt agresionit dhe luftimit, humbjes së lirisë së të tjerëve dhe tejkalimin e kufijve të pranueshëm dhe mosmarrëveshje, përveç nëse ekziston një kontroll etik dhe ballans fetar që diversitetin dhe ndryshimin e konsideron mëshirë në të cilën mendjet dhe shpirtrat prehen me kryqëzimin intelektual, shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, arte dhe industri të ndryshme, mbase kjo mund të jetë pjesë e asaj që dëshiron teksti Kur'anor: *"O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."* (Huxhurat, 13)

Zoti i Madhëruar ia mundësoi njeriut rrugëtimin në tokë dhe det, të ecë në brendi të tokës, të ecë me energjinë e tij mendore dhe vullnetin e lirë

[1] Ibn Ashur, *Tahriri ve tenvir,* vëll. XIV, fq.130. Ibn Ashur, Muhamed Tahir, *Et-Tahriri vet-tenvir,* Dar et-Tunisije, 2007, vëll.XIV, fq.130.

[2] Xhabirij, Muhamed Abid, *El akël el ahlakij el arabij,* Merkez derasat el vahde el arabije, 2009, fq.79.

drejtë shtigjeve të civilizimit që të zbulojë me njohurit e tij argumentet e Zotit në horizont, kështu Ai tha: *"Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja."* (Mulk, 15)

Vizioni i vërtetë islam bllokon plotësisht rrugën përballë mundësive të grindjeve dhe konflikteve, të cilat shpesh vijnë nga porta e mendimeve të ndryshme dhe doktrinave intelektuale dhe ideologjike, vlerësimi i racës dhe nacionalitetit, duke e drejtuar qenien njerëzore drejt qëllimeve të nderuara, si ndërtimi i tokës dhe shfrytëzimi i resurseve jetësore që Zoti i Madhëruar i krijoi, pasurinë bimore, shtazore, detare dhe tokësore, për të arritur mundësi të barabarta, përhapjen e drejtësisë etj, që diversitetin, heterogjenitetin dhe ndryshimin e shndërrojnë në mëshirë dhe mirësi për mbarë botën.

2. Liria e besimit

Liria e mendimit dhe besimit është e drejtë themelore e njeriut e cila përveç që ka rëndësi të madhe për jetën e individit në veçanti, gjithashtu ka rëndësi të jashtëzakonshme për shoqërinë në përgjithësi. Kjo e drejtë përfshin një gamë të gjerë të mendimeve dhe besimeve, dhe në këtë mënyrë paraqet një burim të pluralizmit i cili është pjesë përbërëse e demokracisë. Duke marrë parasysh se në mbarë botën është i pranishëm një diversitet i madh i mendimeve dhe besimeve fetare dhe jo-fetare, garantimi i lirisë së çdo feje dhe besimi përbën një sfidë për çdo shoqëri demokratike. Të gjitha fetë dhe besimet e ndryshme duhet të bashkëjetojnë të lira duke mos u ndeshur me njëra-tjetrën apo me të drejtën në përgjithësi. Prandaj, garantimi adekuat i kësaj të drejte është nevojë e kohës për të shmangur konflikte që mund të lindin si pasojë e pranisë së diversitetit në shoqëritë demokratike.

Islami është fe që siguron dhe garanton liri të ideve, të mendimit dhe të jetës. Ai ka lëshuar urdhëresa për të penguar dhe ndaluar tensionin, konfliktet, shpifjet. Madje, edhe mendimin negativ mes njerëzve. Në të njëjtën mënyrë e me të njëjtën vendosmëri që ai i është kundërvënë terrorizmit dhe të gjitha akteve të dhunës, ka ndaluar presionin ideologjik

ndaj njerëzve: *"Nuk ka detyrim në fe. Rruga e drejtë dallohet qartë nga e gabuara."* (Bekare, 256)

Nisur nga ky realitet, liria është e drejtë e garantuar me ligje hyjnore, marrëveshje ndërkombëtare dhe ligj. Në të drejtën islame nga të qenit thjesht një e drejtë ajo ngritet derisa bëhet domosdoshmëri e jetës njerëzore dhe synim nga synimet më të rëndësishme të Sheriatit. Studiuesi islam Muhamed Tahir bin Ashur, Zoti e mëshiroftë, thotë: *"Barazimi i anëtarëve të ummetit në sjelljen e tyre është nga qëllimet bazike të Sheriatit. Kjo është ajo që nënkupton lirinë."*[1]

Kur'ani Famëlartë fton në njohje midis popujve, ku në të thuhet: *"O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."* (Huxhurat, 13)

Teksti Kur'anor konfirmon rregull në këndvështrim të përgjithshëm të njerëzve me ngjyra dhe kombësi të ndryshme, dhe pohon se diversiteti etnik dhe gjuhësor, dallimi kulturor dhe shoqërorë realisht nuk i shton asnjë vlerë këtij ndryshimi, pasi që nuk është ndarje midis kombeve dhe popujve, ose arsye për ndjenjë të superioritetit racor ose kombëtar, apo duke përjetësuar armiqësi dhe urrejtje mes tyre. Përkundrazi, teksti fton që ky dallim të përdoret në njohje, bashkëpunim dhe hapje midis popujve, kulturave dhe civilizimeve.

Njohja (et-tearuf) është cilësi që synon ndërveprim pozitiv me tjetrin, për të përfituar nga përvoja e njerëzve përmes konvergjencës, komunikimit, dhe forcimit të marrëdhënieve për të arritur integrimin njerëzor. [2]

Nisur nga kjo, multikonfesionalizmi brenda një shoqërie dhe raporteve ndërmjet religjioneve të ndryshme paraqet thelbin e lirisë, barazisë, drejtësisë e demokracisë së atij vendi.

a. Monoteizmi bazë e lirisë: Kur Profeti Muhamedi (a.s.) solli besimin monoteist, besimi në një Zoti të vetëm, në një shoqëri politeiste, mekasit e kundërshtuan ashpër dhe e përndoqën atë dhe

[1] Ibn Ashur, Muhamed Tahir, *Mekasid esh-sheria*, mekteb el vakfije, Katar, 2004, vëll.I, fq. 371.

[2] Ibn Ashur, *Et Tahrir vet-tenvir,* fq. 212.

ndjekësit e tij për 13 vjet me radhë. Profeti u detyrua të emigronte në Medinë, por mekasit nuk e lanë dhe e sulmuan edhe Medinën. Ishin këto rrethanat kur zbritën këto vargje të Kuranit:**"Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Në të vërtetë Allahu është i Fuqishëm që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: "Zoti ynë është Allahu." Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtetë, Allahu e ndihmon atë që e ndihmon Allahun. Allahu është vërtetë i Fortë dhe i Plotfuqishëm."** (Haxh, 40-41)

Teksti kur'anor përmend kishat dhe sinagogat para xhamisë, kjo shpallje hyjnore po vendoste gurthemelin më të fuqishëm të lirisë fetare dhe të mbrojtjes së saj për mbarë njerëzimin. Këto ajete janë zbritur afërsisht në vitin 624, të cilat janë praktikuar nga vetë Profeti Muhamed (s.a.) në gadishullin arab dhe modeli i tij do t'i bënte edhe halifët e tij të praktikonin në të njëjtën mënyrë. Një shembull të vendosjes së lirisë fetare, në zbatim të porosisë së shenjtë që përmendet në ajetet e sipërshënuara, shohim në kohën kur muslimanët triumfojnë mbi Jerusalemin.[1]

b. Nuk ka detyrim në fe: Ky respekt hyjnor është ajo që i bën veprimet e një personi të mbështetur në zgjedhje dhe vullnet të lirë, i cili nuk është i detyruar. Në Kur'an thuhet: *"Në fe nuk ka dhunë"* (Bekare, 256)

Nga ky dhe shumë ajete tjera kuptojmë se liria është parakusht për fenë dhe besimin në Zot, kështu që Zoti nuk e pranon besimin që nuk buron nga qëllimi dhe vullneti i lirë.

Muhamedi (a.s) në shtetin islam, me ligj e kishte garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e pjesëtarëve të feve qiellore. Në një hadith të Pejgamberit (a.s.) thuhet: *"Aí që mundon një hebre ose një të krishterë, në Ditën e Gjykimit mua do të më gjejë si paditës."*

[1] Dr Hasan et-Turabi, *Kadaja el vahde el hurije,* 29

Islami gjatë tërë historisë, në gjirin e vet asnjëherë nuk ka pasur grupe inkuizicioni, dhe asnjëherë nuk ka pasur për qëllim ndërrimin me forcë të fesë së ndonjë populli. Mbi gjitha, ky është vullneti i Krijuesit të gjithësisë, dhe kush mund të marrë guximin të ngrihet kundër vullnetit të Tij!

c. **Liria e fjalës dhe shprehjes së mendimit**: paraqet të drejtën themelore të njeriut e cila ka rol thelbësor në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera. Koncepti i islamit ndaj lirisë së të menduarit dhe lirisë së të shprehurit është një koncept i qartë i formuluar që në fazën parapërgatitore të krijimit të qenies njerëzore, kurse sa i përket lidhshmërisë mes njeriut dhe koncepti mbi lirinë e shprehjes dhe të menduarit, Islami këto vlera edhe praktikisht i demonstroi që me krijimin e njeriut të parë, Ademit a.s.[1]

Nëse shfletojmë Kur'anin Fisnik dhe e lexojmë me vëmendje, vërejmë se krahas shumë çështjeve të tjera jetike, në mënyrë precize rregullon edhe çështjen e së drejtës së shprehjes. Ai na tregon se vlerën e së drejtës së të shprehurit, Islami e implementoi në praktikë që në fazën parapërgatitore të njeriut, përmes debatit të Krijuesit Absolut me krijesat e Tij, engjëjt në njërën anë, dhe me djallin në anën tjetër.

Allahu Fuqiplotë në Kur'anin Fisnik thotë: *"*(Përkujto o Muhamed) **Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj** (po përcaktojë) **në tokë një zëvendës!" Ata thanë: "A do të vësh në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini!"** (Bekare, 30)

Nga ajeti në fjalë vërejmë se Allahu Fuqiplotë kur kishte vendosur që të krijojë njeriun, para se të bëjë krijimin e tij, i kishte informuar engjëjt për hapin që do ta marrë për krijimin e njeriut. Në këtë rast engjëjt – melaqet, edhe pse Allahu xh.sh. nuk kishte kërkuar nga ato mendimin apo ndihmën e tyre, ato duke shfrytëzuar të drejtën e shprehjes, shprehën mendimin e tyre, duke thënë: *O Zoti ynë, a po krijon njeriun i cili do të bëjë çrregullime dhe gjakderdhje.* Ato sikur deshën të thonin se nuk ka nevojë për krijimin e një krijese tjetër, sepse ne të adhurojmë dhe të madhërojmë

[1] El Buti, Muhamed Seid, *Hurijetul insan fi dhili ubudijetullah*, Dar el Fikër, Damask, 2015, fq. 30.

ty pa kurrfarë kontesti dhe mangësi. Krijuesi Absolut edhe pse nuk kishte kërkuar as mendimin e tyre e as ndihmën e tyre për këtë çështje, porse thjesht i informoi duke i paralajmëruar për obligimet me të cilat do të jenë të detyruara në të ardhmen me krijimin e kësaj krijese, Ai sërish shprehi gatishmëri të dëgjojë mendimin e tyre, pavarësisht se engjëjt nuk ishin rival për bisedë me krijuesin a tyre. Pastaj Allahu Fuqiplotë pasi dëgjoi mendimin e krijesave të tij, nuk i qortoi ato se nuk kanë të drejtë të japin mendimine tyre në çështjet e krijimit, e as nuk i sanksionoi, përkundrazi, u tregoi atyre se për çështjet e krijimit, *"***Unë di atë që ju nuk e dini".**

Pavarësisht nga besimi fetar që mund të ketë dikush, qoftë ai çifut, i krishterë, budist apo hindu, Kur'ani u bën thirrje myslimanëve që të jenë tolerantë, falës dhe të sillen me drejtësi e në mënyrë njerëzore ndaj tyre.

Detyrimi i njerëzve për të besuar në një fe apo për të pranuar format e saj të besimit, është në kundërshtim të plotë me thelbin dhe shpirtin e Islamit. Sipas Islamit, besimi i vërtetë është i mundur vetëm nëpërmjet vullnetit dhe ndërgjegjes së lirë. Sigurisht që myslimanët mund të këshillojnë dhe nxisin njëri-tjetrin në cilësitë e moralit kuranor. Të gjithë besimtarët janë të obliguar t'u sqarojnë njerëzve këtë moral dhe t'u japin shpjegime në mënyrën më të sjellshme të mundshme[1]. Ata duhet të tregojnë për bukuritë e fesë në dritën e ajetit kur'anor që thotë: *"Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi e fjalë të mira."* (En'am, 125)

Besimtarët nuk mund të përdorin kurrë dhunën dhe as ndonjë lloj presioni fizik apo psikologjik. Atyre nuk u lejohet as të përdorin epërsinë e mundshme materiale për të detyruar dikë në çështje të fesë.[2] Kur ftesës së tyre në besim i jepet përgjigje negative, myslimanët duhet të përgjigjen në linjat e vargut kuranor që thotë: *"Ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time."* (Kafirun, 6)

Në botën ku jetojmë, gjenden shoqëri që karakterizohen nga besime të ndryshme: të krishterë, çifutë, budistë, hindusë etj. Myslimanët që jetojnë në këtë botë, duhet të jenë tolerantë ndaj të gjitha besimeve dhe të sillen me

[1] Nedevi, Ebul Hasan Ali el Husejn, *Ma dha haserel alem bi inhitat el muslimin,* Mekeb el iman, 2005, fq. 192.

[2] Sigar, Hasan bin Musa, *Et-Teadudije vel hurije fil Islam,* Bejrut, 2014, fq. 85.

drejtësi e humanizëm. Kjo përgjegjësi, me të cilën janë të ngarkuar besimtarët, vlen edhe për t'i ftuar njerëzit në bukurinë e fesë së Zotit me mjetet e paqes e tolerancës. Vendimi përfundimtar për t'i zbatuar apo jo këto vlera, për të besuar apo jo, qëndron në krahun tjetër. Imponimi ndaj dikujt për të besuar, apo përpjekja për t'i detyruar atij diçka, përbën shkelje të moralit kuranor. Në të vërtetë, Zoti në Kuran na sjell ndër mend sa më poshtë: *"Nëse Zoti yt do të kishte dëshiruar, të gjithë njerëzit në tokë do të kishin besuar. Mos vallë mendon se mund t'i detyrosh njerëzit të besojnë?"* (Junus, 99)

3. Raportet midis Bashkësive Fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Nuk ka dyshim se besimet fetare kërkojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe predikojnë barazi midis qenieve njerëzore. Ato hedhin poshtë çdo formë të diskriminimit racor, kulturor dhe fetar, duke bërë thirrje për lirinë e të gjithëve, pa imponim në fe dhe ndërhyrje në lirinë individuale të njerëzve.

Është më se e qarte se Islamit si fe, nuk përjashton asnjërën nga fetë monoteiste, hebraizmin apo krishterimin, prej ndërveprimit ndërkulturor apo bashkëjetesës multietnike. Përkundrazi, Islami bashkëvepron ngushtë duke promovuar elementet e përbashkët përmes së cilës ndërtohen kulturat qytetare brenda një shteti nëpërmjet urave të komunikimit të drejtpërdrejt.

Nëse i analizojmë dhe i zbërthejmë mirë burimet kryesore të fesë islame, Kur'anin dhe Traditën profetike, do të shohim se të dy burimet, me format dhe rregullat e tyre, në mënyrë reale trajtojnë çështjen e dialogut ndërfetar, tolerancën, barazinë dhe bashkëjetesën ndërmjet besímtarëve me përkatësi të ndryshme fetare dhe kombëtare.

Duke marr parasysh këta rekomandime, atëherë parashtrohet pyetja se vallë, kush jemi ne dhe si duhet të jetojmë? Ne jemi njerëz me identitete të ndryshme, shumë të tjerë janë pjesë e asaj që jemi ne. Mund të orvatemi t'i hudhim prej vetes me qëllim që ta gdhendim identitetin e jashtzakonshëm, por atëherë jo vetëm që do të kryejm dhun ndaj të tjerëve, por edhe ndaj vetvetes. Atëherë kush është tjetri? Të tjerët janë fqinjët tanë të cilët dallojn prej nesh sipas kulturës dhe karakterit, ndoshta është si faktor dhe gjenerator i konflikteve tona me ta, por duhet të kemi një gjë të

qartë se të tjerët nuk janë vetëm të tjerë por edhe ata kan identitet, komplekse dhe dinamikë, pjesë e të cilave jemi edhe ne, nëse jemi fqinjët e tyre. Sikur që të tjerët janë fqinjët tanë edhe ne jemi fqinjë të tyre dhe kemi një histori të përbashkët me ta.

Për sa i përket shtetit në të cilin ne jetojmë, gjegjësishtë, Maqdonisë Veriore është shtet multietnik dhe multikonfesional, andaj, dialogu mes popujve dhe shoqërive me diversitete të ndryshme kulturore dhe fetare në të vërtetë është synim dhe sfidë jo vetëm për RMV por për gjithë rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.

Mar parasysh këtë realitet, mbajtja e konferencave, simpozumeve duke trajtuar tema që i tangojnë Bashkësit fetare, besojë se ndihmon dhe atë në avancimin dhe kultivimin e vlerave tolerante, paqësore në shoqërinë tonë multikonfensionale dhe multikulturore. Nga ana tjetër, angazhimi i Bashkësive fetare, institucioneve të larta akademike-shkencore, intelektualve, teologëve si dhe angazhimi i studentëve në zhvillimin e proceseve të dialogut ndërfetar, integrues dhe paqendërtues, mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërisë dhe jo vetëm, në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nisur nga ky realitet, në vitin 2003/04, Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar në bashkëpunim me BFI, Fakultetin e Shkencave Islame (FSHI), Kishën Ortodokse Maqedonase, Fakultetin e Bogoslovis (PBF), Kisha katolike, Kisha Ungjeliste Metodiste dhe Komuniteti hebreik në Maqedoni filluan një program pilot të Lidhjes Fetare në Maqedoni. Rezultatet e programit pilot të PRM, por edhe vlerësimi i programit, treguan se bashkësitë fetare kanë interes të zhvillojnë dialogun dhe të fillojnë bashkëpunim më aktivë reciprok.

Programi ishte planifikuar të zgjasë 3 vjet (2005-2007), dhe i njëjti zgjati deri në tetor 2008, ku përfshirja e profesorëve të dy fakulteteve teologjike, studentëve dhe anëtarëve në procesin e formulimit të programit dha rezultate të kënaqshme.

Qëllimi i programit QMBN ishte pasurimi i bashkëpunimit midis bashkësive fetare dhe mirëkuptimi i tyre me publikun. Grupi i synuar ishte publiku i përgjithshëm, me përqendrim te studentët në të dy fakultetet teologjike (FSHI dhe FB) dhe anëtarët e bashkësive fetare: BFI, KOM, KK, KME dhe Komuniteti hebre në RM. Programi kishte për synim njohuri

mbi fetë e ndryshme, ndërgjegjësimin e kulturave të ndryshme dhe përmirësimin e ndërgjegjësimit të bashkësive fetare, si mes vete ashtu edhe publikut të gjerë.

Për të arritur rezultatet e planifikuara, u realizuan aktivitete të ndryshme të cilat u ndanë në tre pjesë, dhe atë:

Edukim: Mbështetje për zyrat e bashkëpunimit të dy fakulteteve, organizimi i leksioneve, shkëmbimit midis fakulteteve dhe komuniteteve fetare, vizita në shkolla teologjike, kampe verore ndërfetare, vizita studimore dhe trajnime për aftësi themelore për studentët e fakulteteve teologjike.

Kulturë: vizita në objektet fetare; nxjerrja e një kalendari të përbashkët ndërfetar, organizimi i debateve lokale dhe krijimi i një fondi për iniciativat e bashkësive fetare.

Informacioni: Buletini i bashkëpunimit ndërfetar, studime krahasuese, adresuesi i bashkësive fetare, transmetimi i emisioneve në radio dhe TV të temave në lidhje me dialogun ndërfetar.

U bë shkëmbimi i profesorve të dy fakulteteve teologjike të cilët zhvilluan ligjërata për të informuar studentët mbi bazat e religjionit, historisë, kulturës fetare etj. U mbajtën seminare, vizita të objekteve dhe kulteve fetare, brenda dhe jashtë vendit, e cila u prit mirë nga studentët e dy fakulteteve dhe nga opinioni i gjerë.

Gjatë asaj periudhe, BFI dhe FSHI morën pjesë në aktivitete por me një ritëm më të ngadalsuar. Arsyeja e zvoglimit të dinamikës ishte mosmarrëveshja që u ngrit ndërmjet BFI-së dhe KOM-it për anëtar të Bordit Menaxhues në MCMS, ku gjatë kësaj periudhe në Strugë u mbajt Konferncë "Bashkpunimi mes Bashkësive Fetare në Ballkan", ku nuk ishte e ftuar Bashkësie Fetare e Republikës së Kosovë për arsyeveç më të njohura.

Për sa u përket përfaqësuesve fetar në RMV në vazhdimësi bëjnë thirrje për tolerancë, njohje, dialog dhe bashkëpunim reciprok ndërmjet komuniteteve fetare për të rritur stabilitetin dhe për të garantuar paqen në RMV dhe rajon. Megjithatë, realiteti është krejtësisht ndryshe. Në mes tyre nuk ka kontakte, vizita, madje, edhe uratat për ditë festive janë shumë të nivelit të ulët. Andaj, nuk mjafton vetëm të flitet, por e njëjta të hudhet në zbatim.

Marr këtë realitet të hidhur, Bashkësit Fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të përfitojnë nga rasti që ata të jenë promotor të paqës, mirëkuptimit, tolerancës e jo gjenerator të përçarjeve, gridjeve dhe të bijen pre e politikave ditore. Mirëpo, duhet të kemi diç të qartë se, afërsia apo afrimi fizik i dy apo tre religjioneve në një vend nga vet fakti nuk është i mjaftueshëm për të siguruar besim tek pjestarët e religjioni tjetër. Gjatë shumë shekujve në Asfahanë, krishterët kanë jetuar afër myslimanëve. Madje, shumë prej tyre kanë qenë shokë të ngusht dhe kan bërë tregti mes veti. Mirëpo, shumë rallë kanë debatuar dhe shkruar për dallimet dhe problemet që i tangonin të dy palët, myslimanët dhe të krishterët.

Fatkeqësishët, multikonfesionalizmi dhe multikulturalizmi brenda një shoqërie të lirë është i hendikepuar nëse subjekti tjetër, shteti nuk i njeh statusin kulturor, fetar apo etnik palës tjetër plotësisht si vlerë kombëtare, duke e konsiderur njërin si subjekt të rendit të parë dhe tjetrin të rendit të dytë. Një bashkësi fetare më të privilegjuar dhe më të avancuar nga tjetra, a tërë këtë e bëjnë në emër të ligjit, fatkeqësishtë, të gjithë thiremi se para Zotit dhe ligjit jemi të barabartë. Besojë se kjo është edhe aryeja e raporteve të zbehura mes Bashkësive fetare me njëra-tjetrën.

Konkluzion

Nisur nga kjo që prezantuam mund të konstatojmë se multikonfesionalizmi dhe multikulturalizmi brenda një shoqërie paraqet thelbin e lirisë, barazisë, drejtësisë e demokracisë së një vendi. Si mungesë e një qasje të këtillë, konfliktet janë produkt i mospranimit të gjendjes faktike si një vlerë e përbashkët përmes së cilës arrihet deri te kultura qytetare në të cilën mbizotëron paqja dhe harmonia mes grupeve kulturore, etnike e fetare. Andaj, për të realizuar një objektiv ndërkulturore brenda një shoqërie, grupet e ndryshme kulturore, fetare apo etnike duhet të trajtohen si vlerë e përbashkët përmes së cilave mësojmë të bartim elementet e përbashkët të sukseseve reciproke, ndërsa bindjen e tjetrit të respektojmë plotësisht si një e drejtë e garantuar hyjnore, pa e ndarë atë mes kulturës dhe besimit apo kulturës dhe etnisë.

Islami nga besimtarët e vet jo vetëm që kërkon dialog, bashkëpunim, mirëkuptim me pjesëtarët e feve tjera, por ai shkon edhe më

larg, dhe nga bashkëpunimi reciprok kalon në shkallën e njohjes, që është shkalla më e lartë e tolerancës, dhe garanci për të drejta të barabarta mbarënjerëzore si vlera universale për bashkëjetesë.

Gjatë gjithë historisë feja ndër shqiptarët ka luajtur dhe luan rol pozitiv. Bashkekzistenca trikonfesionale, e verifikuar ndër shekuj është shtyllë e qytetërimit shqiptar e cila duhet marr si shembull nga të tjerët në rajon, dhe se për këtë besojë se meritë të veçantë kanë Bashkësitë Fetare të cilët janë në nivel të misionit të tyre dhe nuk lejuan keqinterpretimin e parimeve fetare.

Ndaj mendimin se opinioni përmes konferencave shkencore, simpoziumeve, debateve mund ta njohin më mirë njëri-tjetrin dhe rolin që duhet të luajnë Bashkësitë fetare në shoqërinë multikonfesionale dhe multikulturore.

Në fund dëshiroj të potencoj se dallimi fetar, kulturor, nacional, racor, është dëshirë apsolute e Zotit, kurse ata të cilët besojn në Zot patjetër të mësojnë se si duhet të jetohet në shoqëri multikonfesionale dhe multietnike dhe në botën e diversiteteve.

Bibliografia

(1) Buti, Muhamed Seid Ramadan, *Hurijetul insan fi dhili ubudijetillah,* Dar el fiker, Damask, 2015.
(2) Ibn Ashur, Muhamed Tahir, *Et-Tahriri vet-tenvir,* Dar et-Tunisije, 2007.
(3) Ibn Ashur, Muhamed Tahir, *Mekasid esh-sheria,* mekteb el vakfije, Katar, 2004.
(4) Ived, Xhabir Seid, *Mef'hum et teadudije,* Kuvajt, vezaretul eukaf, 1993.
(5) Nedevi, Ebul Hasan Ali el Husejn, *Ma dha haserel alem bi inhitat el muslimin,* Mekeb el iman, 2005.
(6) Sigar, Hasan bin Musa, *Et-Teadudije vel hurije fil Islam,* Bejrut, 2014.
(7) Shirazi, *El Hurijetu fil Islam,* Bejrut, Dar el firdeus.
(8) Turabi, Abdullah Hasan, *Kadaja el vahde vel hurije,* 1980.
(9) Xhabirij, Muhamed Abid, *El akël el ahlakij el arabij,* Merkez derasat el vahde el arabije, 2009.

A MUNDET MODELI ISLAM I TOLERANCËS, MILTIKULTURALIZMIT, E MULTIFETARIZMIT TË BËHET ALTERNATIVË E DEMOKRACISË?

Fadil MALOKU
Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti i Prishtinës,e-mail: fadil.maloku@uni-pr.edu

Abstrakt

Fundshekulli ynë siç e dimë të gjithë ishte periudhë e ndryshimeve të mëdha në gjithë botën edhe me vetë faktin se zhvillohej një revolucion i përgjithshëm kundër ideologjisë së komunizmit dhe platformës obskurante të luftës së ftohët, të cilat njerëzimit i sollën; mjerim, skamje, luftëra të pakuptimta, dhe varfëri morale e materiale, që të mbushnin mendjen se është fjala për një "fund të paparë të historisë", siç do të shprehej Frensis Fukajama1) figurativisht.
Ç' është më interesant, një vlerësim i ngjashëm, do të thoshim fatalist përkitazi me ndryshimet e mundshme dhe pasojat që do të sillnin ato me vete në sistemet e Evropës, thuhej edhe gjatë luftës së parë botërore. Bile atëbotë, ai vlerësim atëherë konsiderohej si luftë e fundit, luftë kundër të gjitha luftërave tjera të mëparshme që zhvillohej me motive të zgjerimit të demokracisë. Por ç' ngjau? Nuk ndodhi as "fundi" e as "fillimi i fundit"; demokracia, si alternativë modeste e ndërtimit të raporteve mes njerëzve, nuk u vendos! Në vend të sajë nëpër Evropë me gjuhën e dhunës u futën përbindëshat e komunizmit (1917) dhe fashizmit (1939). Lufta e dytë botërore, gjithashtu, nga historianët do të mbahet në mend me tensionimet dhe kërcimet globale që si pasojë e lindën luftën e ftohët, për të vazhduar luftërat ne Gji, në ish Jugosllavi (Kroaci, Bosnjë,Kosovë, bombardimi i Serbisë), në Afganistan, në Irak, në Ukrainë, në Siri.

Fjalët Kyçe*: Fundshekulli,Evropa Juglindore, Ish Jugosllavia, Lufta e Dytë botërore, lufta midis civilizimeve, islami dhe demokracia, qendra dhe periferia,"protestantizmi" islam, terrorizmi, ekstremizmi, etj.*

Përpjekja permanente për të provuar dhe riprovuar shartimin e demokracisë nëpër vendet e Lindjes, duket se akoma po mbetet një punë "Sizifi", edhe për faktin se: demokracia më nuk po mundet të eksportohet aq lehtë sikurse teknologjia, kultura, mallrat, kapitali dhe vlerat tjera, siç dikur bie fjala mendonin kolonizatorët anglez; përmes dërgimit to parukave nëpër koloni dhe "telefaks Kushtetutave". Doktrina e demokracisë e identifikuar tani gjithnjë me petkun e globalizmit, po dëshmohet ende si një "kafshatë që nuk po kapërdihet" edhe aq lehtë nga shumica e diktatorëve të Lindjes, në mendjen e te cileve ajo është ngulitur vetëm si mjet për t'i ruajtur privilegjet dhe begatitë materiale për vetën dhe familjet e tyre, e asesi si mekanizëm ku sundon ligji dhe rritet mirëqenia e qytetarëve të tyre.Në anën tjetër, klerikët fetar të këtij rajoni dhe gjithandej botës sikur i kanë ndihmuar që në start paragjykimit rreth këtij diskursi, edhe me faktin se asnjëherë gjerë tani nuk e kanë parë si të nevojshme një proces të ridefinimit apo mbarevajtjes së tij e kohën, në mënyrë që ai të ecën apo të fuqizohet me koherencën e kohës dhe procesit të globalizimit.

Duket, se sistemi dhe filozofia islame në këtë drejtim në mënyrë të pakontestueshme, do të mund të zinte vendin e frymëzuesit dhe udhërrëfyesit shpirtëror të njerëzve të rëndomtë në të ardhmen. Ngase, nuk ekzistojnë dallime aq të mëdha civilizuese midis vlerave universale të cilat do të mund të ngërthenin kundërshtitë e shfaqura alarmuese në këtë fillim viti, në mes civilizimit perëndimor dhe atij islam që kanë filluar ta përjashtojnë njëra tjetrën.

Globalizimi esktremizmi terorrizmi dhe islami

Është një thënie e njohur diku ku thuhet që ;"Urrejtja ndaj islamit po bëhet gjithnjë më e madhe se sa dashuria ndaj demokracisë (!), ose, dashuria ndajë demokracisë, po bëhet gjithnjë më e vogël, se sa urrejtja ndaj islamit". Gjithashtu, edhe një tjetër që thotë; "*Largohuni nga ekstremizmi në fe, sepse ekstremizmi dhe pamaturia në fe i kanë shkatërruar ata që kanë qenë para jush*"!Qytetarët e rëndomtë shqiptar nuk kanë ndonjë arsye të theksuar që t'i frikësohen islamit burimor, ose, nuk kanë arsye ta urrejnë islamin si fe me parime dhe fondamente monoteiste, paqësore! Ngase,

çështja e cilitdo besim mbrohet, garantohet dhe kategorizohet me legjislacion dhe me Kushtetutë dhe me ligje. Ata, kanë arsye shumë më tepër që t'u frikësohen interpretuesve injorant, medieve dhe rrjeteve islamofobe, e sidomos mercenarëve të frustruar islam e joislam!!Në kushtet dhe rrethanat e disa proceseve dhe zhvillimeve globale, paragjykimi i islamit si fe monoteiste (s 'bashku me krishterimin dhe judaizmin), sot në mediet globale dhe rrjetet sociale, është në rritje e sipër! Ajo çka është më shqetësuese, është fakti që interpretimet nuk po bëhen nga ekspertët profesional dhe njerëzit kompetent të fushave dhe lëmive përkatëse, por nga mediokret medial, pastaj islamofobët dhe grupet e ndryshme dogmatike të proveniencës islame dhe joislame.Natyrisht, interpretimet e tilla jokompetente, sjellin edhe stigmatizim e stereotipizim që e vështërsojnë depërtimin e vizionit paqësor të islamit të vërtetë! Dhe si pasojë i gjithë këtij "mobiliteti" dosido antiislam, paraqitën edhe tendenca monopoliste mbi të "vërtetën" e vërtetë islame! Thënë me thjesht, paraqitën devijime apo ekstremizma të të gjitha llojeve dhe ngjyrave. S'këndejmi, këtyre tendencave nuk mund t'u ikin as shqiptarët e Ballkanit, e as boshnjakët që rastësisht apo jo rastësisht mbetën mysliman me përkatësi fetare!Tani, koha e globalizimit (si më tha një mik një ditë: "na çoroditi" krejt!?) është e vërtetë kohë që ka prodhua shumë armiq dhe shumë mundësi të keqinterpretimeve, për këto religjione monoteiste, e në veçanti për islamin! Shqiptarët, s'ka shans që të implikohen në këto "lojëra" morbide dhe të qëllimshme globale, për një arsy shumë të thjesht: ndjenja kombëtare gjithnjë ka qenë shumë më e fortë se ndjenja fetare. Por, ata fakt që do atakohen edhe për një kohë me stigmatizime e paragjykime nga më të ndryshmet, si nga "qendrat" islamofobe, ashtu edhe nga mediokritetet mediatike, te cilat të frustruara dhe të frymëzuara nga trendet globale, përpiqen t'i konfrontojnë gjëja "dallimet" fundamntale midis religjioneve monoteiste!Midis këtyre qendrave "islamofobe dhe jo islamofobe", padyshim që sot më të "afirmuarit" dhe më të zëshmit në sferën e sigurisë politike e sociale, e sidomos kulturore janë ata që ndërlidhen me termat, e ekstremizmit dhe terrorizmit. Ekstremizmi, si një platformë sociopolitike dhe padyshim edhe fetare, në fakt ka të bëjë me grupe të atilla sociale, politike e edhe fetare, të cilat kanë probleme serioze me identitetin e tyre të luhatur, kontestuar, apo edhe tē humbur për shkaqe të ndryshmet sociale,

politike, kulturore, e civilizuese!Në fakt ideja apo synimi i njeriut, që nga fillimet e hershme sociopolitike ishte dhe mbetet ai i "vetëkërkimit", për origjinën e tij, se kush është ai, prej nga vjen, dhe ku shkon? Një synim identik i "vetëkërkimit", duket se ka të bëjë edhe me grupet, komunitetet, kombet, bile bile edhe religjionet e shtetet (e reja sidomos!)! Pra, imitimi apo identifikimi i shteteve (të reja dhe të vogla sidomos!), me shtetet e mëdha dhe me influencë globale, është pothuajse normal dhe i dukshëm edhe në kohën tonë. Kjo vlen posaçërisht për SHBA-es, Rusinë, Kinën dhe Indinë.Në këtë proces "vetëkërkimi" identitar, pësojnë më së shumti vendet dhe shtetet e ndara (padrejtësisht e historikisht), shtetet e varfra, ato me territor të vogël, e sidomos vendet dhe shtetet që kanë pozitë strategjike në këmbimet, tregtare, sociale e kulturore. Andaj, pakënaqësitë, mospajtimet lidhur me mënyrat e krijimit të raporteve (lexo; varësive të reja; ekonomike, politike, civilizuese dhe sosh kulturore)është e natyrshme të sjellin edhe mendime dhe gjykime "laramane" në (mos)kyçjet e reja me hegjemonët e kohës! Si pasojë, lindin edhe pozicionohen grupe të pakënaqura me këto procese e rrjedha; lokale, rajonale, kontinentale e globale. Për të kuptuar më mirë këto trende global, mendoj që është e udhës të shohim se cka po (nen)kuptohet psh. me termin apo konceptin e shpërndarë dhe të njohur gjithandej në glob.Çka është fundamentalizmi islam? Nëse, dëshirojmë t'i japim një përgjigje tipike shkencore sociologjike, atëherë patjetër që: fundamentalizmin islam duhet shpjeguar edhe si reagim ndaj krizës së identitetit të krijuar nga (post)modernizmi, ndaj tepricës së shoqërive konsumatorizmit, ndaj pafuqisë së imponuar nga padrejtësitë strukturore dhe liberalizimit global të tregut. Faktikisht dhe fatkeqësisht, këtë Íloj fundamentalizmi (se janë prezent ne skenën globale edhe të tjerët…por, me pak gjithsesi) po e "ushqejnë" ekspansioni marramendës i tregut, (që rezultoi me kolapsimin e komunizmit dhe rënien e Murit të Berlinit), dhe interpretimi i fragmentarizuar që i bëhet islamit të sotëm.Duke shikuar, nga ky këndvështrim islami burimor, po bëhet apo të paktën pretendohet të imponohet, jo më si kundërshti ndaj perëndimit, por, si alternativë globale sociale e politike.Ndërkaq, duhet ditur dhe kuptuar që diskursi mbi fundamentalizmin islamik, në fakt në tregun global, është vetëm një katërpërcishi i asaj që është në të vërtetë. Këtu, para së gjithash s'duhet harruar joshjen që mund ta krijojë në të ardhmen rreth temave mbi;

egalitarizmin, përgjegjësinë rreth diversitetit (social, ekonomik, etnik, racor, etj.); konsultimin dhe konsensusin; etj. që realisht i bie një ngatërrim (herë e qëllimshëm, e herë i paqëllimshëm!?) midis asaj që shquhet si edukim fetar dhe histori fetare te religjioneve!A janë njëjtë edukimi fetar me historinë fetare, dhe pse po ndodhë terrorizmi?Duhet kuptuar digresionin se; edukimi mbi etnopsikologjinë fetare dhe çështjet e fakteve rreth historive fetare, nuk janë e njëjta gjë! Ngatërrimi, i këtyre dy kategorive, përveç keqkuptimit social, sjell edhe trauma në sferën shpirtërore (diversitet dhe ndarje kompleksive) dhe pasoja në sferën politike (paragjykime dhe stereotipizime absurde). Ato do ndikojnë edhe më tej në formimin, brumosjen dhe kalitjen e secilit i individ, edhe për shkakun se njeriu vërtetë akoma mbetet një "zoom politikom", social që vulos të tashmen dhe të ardhmen e vetë…., pandalur! Terrorizmin nuk e provokon aq shumë feja, sa e bënë atë ekspansioni i grykësisë së kapitalizmit grabitqar, dhe shërbimet militante të grupeve mercenare që janë në shërbim të dominim (kaosit!) global! Pra, kur kërkohen terroristët, thjesht, duhet të kërkohen njerëzit që blejnë armatim të dyshimtë terrorist, e jo sish që i luten me sinqeritet Krijuesit! ….!Ky termë, si dukuri dhe fenomen sociologjik, është edhe një forme tejet e komplikuar e "trajnimit"të dhunës politike. Për te thuhet që është edhe një lloj ekstremizmi me doza politike! Kurse, ekstremizmi më saktë, mund të definohet si një lloj sjelljeje e atillë sociale që "vegjeton", gjithnjë midis asaj që është e lejuar dhe asaj që është e sanksionuar!Pra, ai është sikur një lloj "parakalimi" mbi një zonë të "minuar"! Për nga numri, ekstremistêt asnjëherë nuk janë shumë, por, janë zhurmues dhe fanatik në qëllimet dhe synimet e tyre! Çfarëdo qofshin, dhe prej kujtdo qofshin, ato! Në politikë, ekstremizmi zakonisht manifestohet si "një lloj animimi i qëllimeve të kornizuara ekstreme, që pretendon gjithnjë të fuqizohet përmes metodologjive normale! Në fakt, ekstremizmi mund të thuhet dhe definohet edhe si një lloj devijimi i skajshëm, edhe për shkak se "vullnetarisht" ikën dhe sistemohet në normat sociale, sportive, politike, e sidomos ato fetare.Ajo çka i jep "shpirt" dhe karakter fenomenit, apo "dosjes" së ekstremizmit janë kryesisht motivet dhe qëllimet politike! Motive dhe qëllime këto, që me karakterin e tyre politik, ekstremizmin e katapultojnë drejtpërdrejt në fushëbeteja dhe ngjyrime; fetare (monoteiste) e ideologjike

(djathtiste e majtiste). Ekstremizmi ideologjik, një rrezik për religjionet monoteiste Tani, ekstremizmi ideologjik djathtist (ai fetar), e kundërshton globalizimin shkaku ruajtjes dhe konservimit të fondamenteve fetare; kurse, ekstremizmi majtist (ai social komunist), globalizimin e projekton si gogol, edhe shkaku i rrezikut nga varfëria…! Kështu që procesi i "vetëkërkimit", është kogja kompleksiv dhe shumëdimensional. Kompleksiv, shkaku se problemet identitare shpërfaqën tani si probleme akute, që kërkojnë urgjenca definimi dhe qartësimi! Kurse shumëdimensional, shkaku se dilemat ekzistuese civilizuese, tek këto vende e shtete të vogla, dhe të varfra, bëhet shpeshherë problematik dhe i rëndësishëm si për "sponzoruesit dhe arkitektët" e pavarësimeve dhe shteteve që u jepet peshë dhe rendësi, qoftë rajonale (Ballkani) apo kontinentale (Azia). Kështu që "krizat" identitare të stilit; "kush jemi ne, prej nga vijmë, dhe ku shkojmë", edhe si shtet, vend e komb, sot janë përditshmëri!Sipas Samuel Huntigtoni, kjo gjendje dhe "krizë" identitare, mund të tejkalohet përmes disa mënyrave. Përmes ndihmës së institucioneve shtetërore, elitave (politike, ekonomike, e kulturore),dhe natyrisht popullsia, e cila duhet të informohet për nevojat, detyrimet dhe kahet e ndryshimeve eventuale, si edhe ndihma nga perëndimi (aludimi është; Amerika dhe Evropa). Duhet kuptuar që integrimet evropiane korrespondojnë me proceset globalizuese. Nevoja për një epistemologji sociale të religjioneve monoteiste Nëpër shkolla publike, sot në botën postmoderne, s'duhet të mbetet më një cilësim paragjykues dhe tentim stigmatizimi për religjionet monoteiste, ashtu siç ishte, apo edhe është aktualisht, në pothuajse shumicën e vendeve të tranzicionit, por, është një nevojë imediate e kohës në mënyrë që t'i shmangemi fundamentalizmave, ekstremizmave dhe terrorizmave të të gjitha llojeve dhe niveleve.Përvoja evropiane na dëshmon se njohjet shkencore (e jo ato pseudo-shkencore) të historive të religjioneve monoteiste (një sferë goxha komplekse dhe e ngarkuar shpesh edhe me klishe pseudo-ekumenike) janë treguar si të shëndetshme edhe për faktin se, mes tjerash, ***a)*** kanë zbutur mendjet paragjykuese, ***b)*** kanë shëruar patologjitë sociale, dhe ***c)*** kanë reduktuar frustrimet e individëve, grupeve, komuniteteve, por edhe të popujve dhe shteteve të ndryshme evropiane. Pra, kjo iniciativë assesi s'duhet kuptuar dhe interpretuar si tentim për të futur "mësim besimin fetar" nëpër shkolla

publike, por si një koherencë kulturore, pra si një njohje ndërfetare midis religjioneve dhe si përvojë e qëndrueshme, ku përmes njohjeve reciproke ndërtohen urat mes feve, konfesioneve, racave, civilizimeve dhe kulturave.Mosnjohja apo mosdija e religjioneve për njëri-tjetrin s'është përparësi, por, pengesë që ka prodhuar, po prodhon dhe do të prodhojë pasoja negative në njerëz dhe të mira materiale, si edhe një frustrim deri në nivel kontinental e global! Kjo, tanim prodhon padyshim edhe fenomenin tjeter aktual e me përmasa globale, te shquar dhe te identifikuar si terrorrizem."*Terrorizmi; nuk ka as komb, as shtet, as … e as fe…! Bota në të cilën po jetojmë ne shquhet si botë e rrezikshmërisë (Risikogesellschaft) së shkallës së lartë*!" (*Ulrich Beck, Risk Society, 325.2009)* .

Dilema "hamletiane" për mendimin tim qëndron në atë se: a duhet ne nga pragu ynë lokal ta refuzojmë dhe ta kundërshtojmë këtë të keqe (gjë që jam tërësisht dakord!), që ka marr përmasa të paparashikuara, apo, duhet të mësohemi të "bashkëjetojmë"me te?Përgjigjen (lidhur me terrorizmin)… po e ka problem e gjithë bota ta gjej! Problemi, (tek shumica e sociologëve bashkëkohor, te paktën çka kam mund ta shoh) qëndron të shkaqet. E ato, mund të gjenden gjithandej: edhe ne tendencën e dominimit, eksploatimit, ndryshimit, imponimit, subordinimit… te kombeve, shteteve, vendeve, rajoneve, kontinenteve…! Por, edhe në synimet vetëpërjashtuese të shtetetve në rënie, kulturave dhe agjentëve tjerë dominues sot ne botë.Tekefundit, kjo është natyra e njeriut, shoqërive, shteteve… etj. por; gjithsesi jo edhe e civilizimeve për të vetmin shkak, se; civilizimi (qytetërimi) është term shumë më gjithëpërfshirës më vetërcaktues, më vetëkërkues dhe shumë më vetëemancipues.!?

A mund dhe si mund te amputohen vlerat e multikulturalizmit dhe multifetarizmit perëndimor në Lindje?

Doktrina e demokracisë po dëshmohet se nuk është një kafshatë e lehtë, as për diktatorët e shumtë të Lindjes, të cilët kanë provuar të bëjnë një shartim të tillë formal, vetëm e vetëm që t'i ruajnë privilegjet e tyre dinastike. Ata ende nuk kanë arritur ta kuptojnë se ajo kultivohet jo përmes autokracisë dhe qeverisjes despotike të qytetarëve të tyre, por përmes institucionit të edukimit dhe mirëqenies qytetare. Sepse mbindërtimi institucional dhe

hapja kundrejt botës është hap që duhet të ndërmerret nga të gjithë, në mënyrë që akti i krijimit të kësaj edukate, (parimisht) kushtëzuese, të mund të ndërlidhej në mënyrë të anasjelltë me dy tipare, ose dy lloje kategorizimesh:

Kategorizimi parë ka të bëjë me aksionet dhe iniciativat e njerëzve që kanë rezon, aftësi dhe kreativitet të mjaftueshëm që të ndikojnë në formën dhe përmbajtjen e sistemit që ata duan ta rregullojnë vetë. Dhe kategorizimi tjetër ka të bëjë me zhvillimin e sistemit të vlerave, njohurive dhe mjeshtërive të civilizimeve të tjera, ashtu siç ishte në kohën e zenitit të shtetit të parë islam, pikërisht në kohën e Muhamedit (alejhi selam). Gjykoj se dilema kryesore që sillet sot në kokat e shoqërive të lindjes vërtitet kryesisht rreth asaj se çka në të vërtetë duhet të provojnë dhe të "dhurojnë" ato diç nga tradita, kultura dhe etnopsikologjia e tyre, në mënyrë që të ridëshmohet apo refuzohet koncepti i demokracisë? Ose thënë më ndryshe, i duhet apo jo sot një lloj protestantizmi civilizimit islam? E themi këtë ngase, sot, ky është provim i pjekurisë së miliona e miliona njerëzve në planetin tonë.

Duket se në këtë drejtim, sistemi dhe filozofia islame do të mund të zinte, në mënyrë të pakontestueshme, vendin e frymëzuesit dhe udhërrëfyesit të këtij rrugëtimi të njerëzve të rëndomtë në të ardhmen, ngase nuk ekzistojnë dallime aq të mëdha civilizuese midis vlerave universale, të cilat do të mund të ngërthenin kundërshtitë e shfaqura alarmuese në këtë fillim MILENIUMI mes civilizimit perëndimor dhe atij islam që kanë filluar ta përjashtojnë njëri-tjetrin.

Pra, si mund të identifikohet situata aktuale globale, pas rrëmujës së shkaktuar nga keqpërdorimi i karikaturave të pejgamberit tonë, Muhamedit a.s.? Duket se sot, jo edhe aq lehtësisht, do të mund të identifikoheshin disa shpjegime. Shpjegimi i parë ka të bëjë me rrafshin e teorisë së Xhon Espozito-s, i cili mes të tjerash konsiston se konflikti i tanishëm i shkaktuar nga keqpërdorimi i karikaturave të pejgamberit Muhamed a.s., duhet dhe mund të përmirësohet vetëm përmes dialogut të mirëfilltë mes dy civilizimeve kryesore, atij perëndimor dhe atij islam. Dhe duhet që këtë dialog ta udhëheqin jo grupet e frustruara radikale, e as pushtetmbajtësit e korruptuar aktualë që qeverisjen e qytetarëve të vendeve të tyre e ushtrojnë përmes një sistemi gjysmë feudal dhe gjysmë fisnor, por organizatat e

ndryshme sindikale dhe sidomos ato studentore, që nuk kanë paragjykime ndaj demokracisë (por që, përkundrazi, projektojnë në demokraci një mekanizëm shumë të sofistikuar për t'i demokratizuar këto shoqëri me qeveri kukulla!). Në këtë drejtim, kujtojmë që ndihmë të çmueshme do të mund të jepnin edhe OJQ-të lokale të rekrutuara nga shoqëria civile.

Në anën tjetër, ky lloj dialogu i ardhur nga Unioni Evropian, para së gjithash do të duhej hapur në "shtëpinë e vet", ku sipas disa të dhënave thuhet se jetojnë përmbi dhjetë milionë muslimanë. Po ashtu, në funksion të këtij dialogu, të themi të brendshëm ndërcivilizues evropian, nuk do të ishte keq të identifikohej edhe ndonjë udhëheqës i moderuar shpirtëror musliman, i cili me autoritetin e tij moral dhe të Islamit autentik do të mund të shërbente si model i interkomunikimeve civilizuese brenda vetë kësaj pjese të perëndimit, në mënyrë që të vërtetohet teza se Islami është në përputhje me rrjedhat dhe zhvillimet e procesit të globalizmit dhe se nuk është kundër demokracisë dhe vlerave të mirëfillta të demokracisë, sepse demokracia, qeveria e kontrolluar nga opozita (pra, sistemi opozitar), të drejtat e njeriut, si edhe ajo kryesorja: sundimi i ligjit, në një mënyrë apo në mënyrën tjetër, janë shoqëruese të jetës moderne, pra, të procesit apo tendencës së identifikuar nga të gjithë si globalizëm.

Dinamika e diktuar pikërisht nga perëndimi, ose thënë më drejtpërdrejt nga Amerika, ka bërë që këto institucione apo mekanizma të huazohen apo të shartohen në kontekste dhe rrethana të reja historike në këtë shekull.

Shpjegimi i dytë, për mendimin tim, ka të bëjë me teorinë e Fukujamës mbi "fundin e historisë", sipas të cilit perëndimi, me rënien e murit të Berlinit, përkatësisht me triumfin që konsistoi ndaj lindjes (përkatësisht ndaj perandorisë së "kuqe"), tani duhet t'ia imponojë përgjithmonë modelin globalist gjithë botës. Shpjegimi i tretë, do thoshim në mënyrë indirekte, është i ndërlidhur me teorinë e prof. të Harvardit, Samuel Huntigtonit, i cili botën e shek. të XXI-të e parasheh përfundimisht si projekt të pushimit të konflikteve: kombëtare, etnike, politike, ekonomike, etj. dhe fillimit të përplasjeve mes civilizimeve!

Për të, konflikti i tanishëm në Lindje, bie fjala, nuk është asgjë tjetër veçse zbatim i mirëpërpunuar i projektit mbi inicimin e përplasjeve mes dy civilizimeve (atij perëndimor dhe atij islam) kryesore për supremacion

global. Në anën tjetër, ky Huntigton, gjykon kundërthënshëm (!) sepse sipas tij tash (me siguri pas bindjes së fituar në lidhje me pushtimin e lehtë të Irakut) Perëndimi nuk ka nevojë të flasë për dy civilizime (ashtu siç kishte pretenduar në fundshekullin e kaluar), por për "Perëndimin (qendrën, shën. i aut.) dhe pjesën tjetër (periferinë, po ashtu shën. i aut.) që nënkupton ekzistencën e disa jo-perëndimeve", ku pikësëpari aludohej për Japoninë, pastaj Kinën dhe ato shtete të Lindjes.

Një ndër dobësitë më kryesore, që i adresohet kësaj teorie dhe vet autorit të saj, është edhe ajo se diskursi i civilizimeve huntigtoniane i anashkalon, apo më mirë me thënë, i përjashton dallimet (organizative, politike, ekonomike, etj.) brenda vetë shteteve që bie fjala e Meditime sociologjike mbi Islamin 97 favorizojnë uniformitetin kulturor dhe atyre që e përjashtojnë pluralizmin kulturor. Në kuadër të këtyre kontestimeve shkencore hyjnë edhe analizat dhe studimet e bëra po nga vetë diskursi perëndimor se numri më i madh i konflikteve etnike nuk kanë ngjarë si pasojë e konfliktit në vija të trasha civilizuese, por, para së gjithash, si pasojë e interesave ekonomike, territoriale, ekzistenciale, etj.

Pra, shumica e konflikteve etnike në botë nuk kanë si shkak përplasjet e qytetërimeve. Gjithashtu, shumica e anketave në vendet e Evropës lindore tregojnë se, pavarësisht prej përkatësisë në qytetërime të ndryshme, sipas kritereve të Huntingtonit, të intervistuarit kanë perceptime dhe pritshmëri të njëjta mbi demokracinë, integrimin evropian dhe çështje të tjera politike (White, Oates & Miller, 2003). Gjithashtu, sondazhet në vendet me shumicën e popullsisë të fesë islame dalin në përfundimin se, në mikronivelin e këtyre shoqërive, demokracia parapëlqehet nga shumica e popullsisë.

Fakti se, në një numër vendesh muslimane janë në pushtet regjimet jodemokratike, nuk do të thotë se shumica e qytetarëve të këtyre vendeve nuk janë mbështetës të një alternative demokratike, diçka që implikohet prej studiuesve që e etiketojnë islamin si kundërdemokratik" (Hofman, 2004: 672).

A është demokracia sharmë i Islamit?

A ia qëlloi Huntigton me teorinë e tij për përleshjet e mëdha? Po ashtu, Huntingtonit mund t'i adresohen vërejtje të theksuara, ngaqë asnjëherë, në asnjë periudhë historike, nuk ka pasur kacafytje apo si të themi përleshje mes civilizimeve.

Historia na mëson se pothuajse të gjitha luftërat e ndodhura deri tani ishin, pak a shumë, luftëra të një dimensioni tjetër, që nuk kishin për motive hasmëritë mes kulturave apo civilizimeve si të tilla, por para së gjithash ishin përplasje mes interesave të ndryshme që kishin kombet, apo më mirë më thënë shtetet, që kishin rolin prijatar të zhvillimeve ekonomike, politike e kulturore me kombet, apo vendet (shtetet), të cilat i kundërshtonin këto procese avancuese jo vetëm për këta të fundit, por edhe për ata vetë. Duket që edhe "përplasja" e fundit, që nga disa po identifikohet edhe si përleshje apo konflikt mes civilizimeve, nuk ka të bëjë edhe gjithaq me shpalljet për shkatërrim të njërit (në këtë rast, civilizimit perëndimor) civilizim ndaj tjetrit (civilizimit islam), se sa me përplasjet e vetë civilizimit perëndimor me problemet e identifikuara në kuadër të tij, siç janë ato që kanë të bëjnë me: ksenofobinë, stereotipat ndaj ardhacakëve të lindjes (rasti i incidenteve në Francë, Holandë, etj), rrezikun ndaj të huajve (në Gjermani p.sh. debatet e vonshme) dhe me frustrimin evident në Islam që aktualisht, për mendimin tonë, është më tepër pasojë e një gjurmimi të një identiteti të ri, apo si të themi një dileme hamletiane mes modernitetit (si ofertë) dhe konservatorizmit (si traditë qindravjeçare). Oferta moderniste, në një mënyrë, është ofertë perëndimore që aktualisht, në kushtet dhe stadet e një procesi apo tendence globalizuese, po faturohet nga të gjitha civilizimet, e posaçërisht nga Islami.Themi Islami, për shkak, se atje kemi të bëjmë me shtete despotike që, po ashtu, nuk Meditime sociologjike mbi Islamin 99 kanë të bëjnë aspak me organizimin hyjnor të ndërtimit dhe të organizimit të pushteteve. Asnjë pushtet sot nuk i përngjan apo nuk identifikohet me shtetin e Medinës, që qe organizuar nga ana e Muhamedit a.s. Për këtë shkak, tollovia e shkaktuar nga keqpërdorimi i karikaturave, në një mënyrë, është edhe një shtegdalje e volitshme për shoqëritë e kësaj pjese të botës që të rifillojnë të krijojnë distancën e duhur politike ndaj pushteteve autokratike dhe të korruptuara po nga diskursi perëndimor, në mënyrë që

edhe dilema e sipërpërmendur: modernitet apo konservatorizëm i mëtutjeshëm, të shndërrohet në një lëvizje apo në një rilindje të vërtetë drejt procesit të integrimeve dhe procesit të shfrytëzimit të mekanizmit të demokracisë së mirëfilltë, për konsolidimet dhe progresin e gjithëmbarshëm ekonomik. Pra, a është demokracia sharmë i Islamit? Ekziston, po ashtu, një bindje shkencore që flet në favor të tezës se edhe në vendet islame ekziston një përkrahje dhe një simpati për diskursin demokratik. Por fakti që, në vendet e trazuara aktualisht, pushtetmbajtësit aktualë autokratikë i bashkëngjiten turmës së demonstruesve dhe qytetarëve, nuk do të thotë se ato janë kundër mënyrës demokratike të qeverisjes dhe të kontrollit. E në këtë kontekst, nuk mund të thuhet se Islami është antidemokratik. Ngaqë, me këtë paragjykim, arrihen dy kundër efekte që, për mendimin tim, janë të rëndësishme për të identifikuar shkaqet e krizës dhe të frustrimit të shteteve të Lindjes: Njëri ka të bëjë me "shkurorëzimin" e demokracisë, ende pa hyrë në "muajin e mjaltit", me pluralizmin, sundimin e ligjit, kontrollin dhe shfaqjen e opinionit opozitar; dhe tjetri, me acarimin permanent mes vetë civilizimit islam (që dosido është moment i disfavorshëm për të) dhe atij perëndimor. Në këtë kontekst, kujtoj që shtrohet një dilemë e madhe, se a thua karikaturat lidhur me Muhamedin a.s. janë përdorur vetëm si një shkak non sensus, e më pak si një pasojë eventuale e nevojës për një "protestantizëm" islam, i cili, pa dyshim, që një ditë do të vijë …!

Si është puna me vlerat fetare në etnopsikologjinë e shqiptarëve

Vlerat fetare, si pjesë e etnopsikologjisë së një kombi, kanë rëndësi të posaçme edhe për vetë faktin se këto vlera, tek shqiptarët andej e këndej kufirit artificial, kanë luajtur një rol tejet të rëndësishëm në ruajtjen dhe konservimin e identitetit kombëtar. Pra, ato janë një kapital i domosdoshëm, përmes të cilit, tekefundit, edhe identifikohen komplekset e kombeve sot e kësaj dite në botën bashkëkohore. Semantika e kuptimit të konservimit të këtij atributi të rëndësishëm për identitetet e quajtura kombe, në rastin e shqiptarëve ka ndikuar shumë. Për këtë shpjegim shkencor do të thosha me kompetencë të plotë do të duhej të na fliste dhe të na sugjeronte sidomos sociologjia e religjionit (të cilën mjerisht akoma nuk e kemi të

konsoliduar në Kosovë!), e cila ndër ne në Kosovë ose nuk mësohet fare, ose nuk përkujdeset fare për shndritjen dhe konceptimin e këtij fakti, i cili në traditën e popujve të ndryshëm ka lënë gjurmë të theksuara. Për sociologjinë e religjionit, interesimet për koncepcionet e fesë janë të rëndësishme, ngase pretendojnë të konsistohen me të arriturat e shkencave, duke e bashkuar kështu edhe raportin teorik, empirik dhe racional, që d.m.th se ajo nuk sheston problematika dhe çështje që anojnë nga sfera e metafizikës dhe qenia transcendentale. Si e tillë ajo, para se gjithash, interesohet për problemet njerëzore në fenomenet transcendentale. Meditime sociologjike mbi Islamin 121 Pra, sociologjia e religjionit nuk merret me çështjen se a janë idetë religjioze në lidhje me raport të shëndoshë me transcendentalen, si raporte të vërteta apo të pavërteta. Por, në anën tjetër, mund të studiohen disa segmente e aspekte të saj në mënyrë shkencore. P.sh. a mund dhe sa mund të fokusohen, bie fjala, interesimet shkencore nga problemet e çështjes së raportit të saj nga komplekset e shoqërisë, nga roli dhe vetitë e disa formave të religjionit, nga kushtet dhe rrethanat në të cilat frymëzohet instinkti i imponimit të religjionit, etj. Sociologjia e religjionit, pra, si shkencë mbi fenomenet e religjionit si fenomen shoqëror, nuk pretendon që çështjet burimore religjioze t'i reduktojë në çështje të preokupimeve njerëzore, përkatësisht shoqërore. Ajo që pretendon ajo janë problemet dhe dukuritë e çështjes së tematizimit religjioz, në kontekst të raporteve të caktuara historiko-shoqërore. Në këtë kontekst, mendojmë se shpjegimi i paraqitjes së fesë islame tek shqiptarët dhe animi i tyre nga Islami, në dallim nga popujt e tjerë ballkanikë: serbë, bullgarë, hungarezë, boshnjakë, etj. pa mëdyshje ka kuptimin e vet të arsyeshëm, i cili, kur krahasohet me rrethanat dhe situatën e atëhershme (kur fillon të arrijë në Ballkan, shek. XIV-XV) të rrezikimit të etnosit shqiptar nga elementet ortodokse dhe katolike, del shumë pozitiv, pasi ishte antipod i vërtetë dhe alternativë e denjë për të konservuar edhe një kohë substancën kombëtare shqiptare nga tëhuajsimi i aleancës ortodokso-katolike, që kishte në tryezë plane morbide për asimilim! Andaj, sot kërkohen padrejtësisht shkaqet dhe pasojat e përcaktimit kolektiv shqiptar në fenë islame. Tekefundit, a nuk e dëshmon këtë sot tendenca e përkatësisë triadike (musliman, katolik, ortodoks) në shoqërinë moderne shqiptare? Në sociologjinë bashkëkohore, pa marrë parasysh orientimet e ndryshme

teoriko-metodologjike, prapëseprapë ekziston një dozë e domosdoshmërisë së ndërlidhjes teorike me hulumtimet empirike të shoqërisë. Në raportet teorike përballë religjionit (ku sintagma "teoria e religjionit", në kuptimin burimor të saj /nga fjala greke "theoria"/ ka kuptimin e këndvështrimit ontologjik), tendencat e shpjegimit shkencor fokusohen drejtpërdrejt nga mundësia e përhershme e besimit të fuqishëm të njeriut në NJË Krijues të Vetëm të kësaj bote, pra në Allahun e Lartmadhëruar. Paradigma filozofiko-sociologjike e tendencës së "vonesës" së shkurorëzimit shqiptar, si edhe identifikimi i arsyeshëm i popullatës shqiptare me elementin turk, kundrohen si pasojë e konservimit dhe e ruajtjes me një xhelozi të madhe të atributeve të shqiptarësisë. Ngase, në një klimë të tillë që u krijua në viset shqiptare gjatë kohës së invadimit turk, si qëllim kryesor ishte lufta kundër pushtuesit, e jo lufta me çdo kusht kundër depërtimit të Islamit. Në anën tjetër, po ashtu, mënyra a qasja e autorëve të ndryshëm për fenomenin e religjionit nuk do të thotë se ata këndvështrimet e veta, në rrethanat dhe ambientimin tonë, ia nënshtrojnë rigorozitetit të profilizuar teoriko-metodologjik dhe deduksionit sociologjik, por para se gjithash institucionit të përvojës racionale, e cila dosido ishte e pranishme në mbarë historinë tonë të bujshme. Si e tillë, për bindjen tonë, sociologjia e religjionit, e cila mungon për shumë shkaqe në shkollat fetare (sidomos) edhe në universitetet tona, ka marrë përsipër të shumtën një mision më tepër të karakterit rrëfyes për problemet e teorisë së religjionit, sesa të karakterit përfundimtar të përvetësimit teorik të njohjes së fenomenit religjioz. Në këtë drejtim, është shumë pozitiv fakti që trajtimin e literaturës dhe problematikës së fenomenit religjioz këtu ndër ne, në Kosovë, e ka marrë përsipër ta botojë pikërisht institucioni fetar, i cili, pa asnjë paragjykim paraprak, përpiqet ta shprehë kulturën islame si pasuri universale për të gjithë njerëzit pa dallim feje, gjinie, kombi, race, etj. Në kontekst të vlerave fetare në vetëdijen e shqiptarëve etnikë të Kosovës duhet shikuar edhe procesi i "invadimit" të vlerave perëndimore, pas luftës së ndodhur në Kosovë, të cilat nuk janë gjithherë vlera të njëmendta, ashtu siç edhe proklamohen në diskursin tonë të përditshëm! E themi këtë ngase tani, pas përfundimit të luftës në Kosovë, ku ka një vakuum të një kontrolli të përhershëm të asaj se çfarë po ngjet në esencë me këtë pjesë të trashëgimisë sonë shekullore, "invadimi" i vlerave të huaja fetare, jo vetëm që është i

mundshëm, por edhe i "obliguar" edhe i "detyruar" nga qendrat e ndryshme fetare e jofetare për të nxitur dhe për të atakuar opinionin e thyer shqiptar. Kjo metodologji, apo ky model i nxitjes së opinionit shqiptar, do të thosha shkurt, është duke u shfrytëzuar me një sistem të përpunuar mirë dhe me një strategji mjaft tërheqëse për të rinjtë tanë. Shtrohet pyetja: Kush duhet ta "mbulojë" vakuumin që "misionarët" e ndryshëm perëndimorë, të fshehur sidomos prapa vellos së "ndihmës humanitare", po e shfrytëzojnë duke tentuar që ta orientojnë rininë shqiptare në gjoja disa vlera të bastarduara dhe jo njerëzore për traditën dhe etnopsikologjinë tonë? Apo, si shpjegohet aftësia "tërheqëse" e këtyre farë misionarëve në një ambient gati qind për qind musliman? Pse këtë sistem të shkurtër "përthithjeje" të këtyre të rinjve nuk e marrin organizatat joqeveritare islame? Në të vërtetë, këto të fundit do të duhej të shqyrtonin metodologjinë e tyre të punës këtu në Kosovë, që për mendimin tim është bërë tejet e dalë nga moda, jo atraktive dhe pothuajse aspak tërheqëse për të rinjtë tanë. Organizatat qeveritare të Lindjes, kanë në të vërtetë në program edukimin dhe arsimin islam këtu ndër ne, por ato nuk duhet të harrojnë asnjëherë se Kosova nuk është Azi, e aq më pak Afrikë. Procesi i kanalizimit të të rinjve, si edhe mekanizmat e animit të kësaj kategorie vitale, do të thosha edhe fara e islamizmit të nesërm në këto troje, nuk duhet të ushtrohen dhe sidomos të imponohen me metodologji të njëjtë si bie fjala në Azi apo në Afrikë! Kjo thjesht ka një përgjigje. Mentaliteti i popullit shqiptar i shkapërderdhur në të gjitha anët e botës, sidomos në pjesën perëndimore të Evropës / asaj pjese, pra, e cila njëherë i përpunon (!) mirë e mirë në mënyrë të pamëshirshme shqiptarët (sidomos) muslimanë, e më pastaj i hedh në "kazanin e shkrirjes" (lexo: asimilues, kombëtarisht e fetarisht)/ ani pse u është ekspozuar drejtpërdrejt vlerave fetare të atij vendi apo shteti, asnjëherë nuk insiston që krahas begatisë materiale të importojë edhe begatinë dhe vlerat shpirtërore të atij vendi apo shteti në Kosovë. Ndërsa tjetër muhabet është tani kur "servimi" i këtyre vlerave, atij nuk i bëhet nga kureshtja, por thjesht nga kushtëzimi material: kuptohet jo direkt në stilin "*merre (kombin) fenë time, unë ta ndërtoj ty shtëpinë!"* Do të ishte absurde sikur të rezonohej në mënyrë kaq naive. Stili i "misionarëve" të jashtëm djallëzorë ka sistem veprimi. Ai nuk ngutet në përvetësimin tënd. Ai të pret, të hulumton dhe t'i studion mirë të metat dhe përparësitë e tua morale e

materiale. Ai të nxit kur ti nuk e pret fare këtë, kur mendon se ke fuqi dhe mundësi të ruash dinjitetin tënd moral e fetar. Por nuk ndodh kështu ngase të "tillët", jam i bindur, janë të trajnuar nergut për këto çështje. Ata përveç "shërbimeve humanitare" janë të shkolluar nëpër kolegjet dhe universitetet me renome, ku mësojnë dhe studiojnë mirë psikologjinë e individit (familjes dhe shoqërisë) dhe të masës së varur (siç është rasti me shqiptarët e Kosovës momentalisht) e cila ka nevojë për "shtytje" në ndryshimin e sjelljeve shekullore. Kosova, pra, sot është bërë poligon jo vetëm i eksperimentit individual , por edhe kolektiv për të gjitha organizatat fetare. Preteksti që ato gjejnë përherë si argument të tyre në sytë e qytetarit dhe të riut tonë ka efekt të hatashëm! Për këtë shkak, sidomos Bashkësia Islame e Kosovës dhe organet e saj duhet t'i kenë parasysh të gjitha këto shkaqe dhe pasoja e të mobilizohen me tërë potencialin e vet shkencor e fetar në drejtim të ruajtjes së vlerave shekullore të shqiptarëve të Kosovës, sepse nëse nuk ndërtohet ndonjë sistem kundërvënës, ajo për një kohë shumë të shkurtër do ta humbasë betejën, e nesër edhe luftën me djallin e misionarëve fetarë perëndimorë. Shkurt, Bashkësia Islame e Kosovës duhet të lirohet nga "vetëkënaqësia" se jemi 90% muslimanë dhe nuk ka kush çka ç'na bëjë! Kjo është e vërtetë, por a nuk thuhet: "Kush mbjell sot, korr nesër", "Kush e zë nusen i pari, atij i takon". Kjo, më së miri, mund të përballohej me armën që ata e njohin më së miri. Po cila është kjo "armë që ata njohin" do të pyeste dikush nga ne, që dëshirojmë t'i konservojmë edhe më tej vlerat tona kombëtaro-fetare? Kjo "armë" qëndron në përvojën e akumuluar gati shekullore të këtyre ardhacakëve perëndimorë, në krijimin e sistemit organizativ, që si domosdoshmëri puqet me të arritura shkencore dhe teknologjike (preokupim ky që diskursi islam e ka vetëm në letër dhe askund tjetër!); në aftësinë mobilizuese brenda një kohe shumë të shkurtër, në krijimin e kultit të punës (që për ta patjetër duhet të jetë në konflikt me parimet fetare: shiko p.sh vetëm "Etikën Protestante" dhe zhvillimin e shpirtit të kapitalizmit, një temë shumë interesante, kult ky që nuk bie ndesh fare me parimet islame. Përkundrazi ai vetëm sa përputhet. Për këtë le të rikujtojmë porosinë e Zotit (xh.sh.) kur i drejtohet Muhamedit (a.s.) me fjalët: IKRE (Lexo, Puno!); kjo armë, pastaj mund të deshifrohet edhe në obskurantizmin dhe neglizhencën shekullore të shkencës, kulturës, traditës, inovacionit islam, gjatë shekullit të kaluar. Do të mund të përmendnim edhe

shumë momente të tjera që e ilustrojnë këtë fakt të dembelisë së diskursit islam, jo vetëm në Kosovë, por në mbarë Botën Islame, gjë që nuk është qëllim i këtij shkrimi. Thënë shkurt, dua të theksoj rrethanat e volitshme demokratike që kanë filluar të fryjnë edhe në Kosovë, për një rizgjim të mirëfilltë shkencor, intelektual, politik, juridik, ekonomik e gjithsesi kuptohet edhe fetar, të cilat do të ndihmonin jo vetëm për ruajtjen dhe konservimin e tipareve të identitetit kombëtar e fetar (së bashku) të shqiptarëve, por njëkohësisht dhe për pasurimin e këtyre vlerave me përvoja pozitive, qofshin edhe perëndimore (p.sh. kulti i punës, angazhimi i sistemuar, kolizioni i angazhimeve shkencore dhe intelektuale dhe ajetet kur'anore që vetëm sa plotësohen), etj. Se, përndryshe, do të jemi në bisht të zhvillimit të ngjarjeve, ashtu siç kemi qenë gjer më tani! Koha është duke punuar për shqiptarët, çështja është vetëm se sa do të dimë ne ta shfrytëzojmë atë**.**

Dija islame s'është vetë dije fetare, por, edhe shkencore, sociale, civilizuese e kulturore

Islami dhe myslimanët, sot janë duke përjetuar rëniet dhe stigmatizimet nga më të ndryshme prej që ekziston bota. Dhe që në fillim më duhet ta ceki se, faji për gjithë këtë margjinalizim dhe këndvështrim paragjykues që i bëhet atij sot, fare se fajësoj botën perëndimore, e as islamin si koncept dhe filozofi, ideologji, mënyrë jetese,...apo si të doni mund ta quani! Por, fajin e adresoj pikërisht te myslimanët! Dikush do pyes, si te myslimanët? Ju lutem, ta sqarojë që në fillim të tezës sime, se aludimi im s'ka të bëjë fare me njerëzit, popullin, komunitetin, umetin (apo si të doni quani) mysliman. Myslimanët si komunitet, asnjëherë s'mund t'i fajësojmë për përgjegjësinë që kanë të bëjnë me sferat; sociale, politike, ekonomike, juridike, ushtarake, kulturore...e civilizuese, por, elitat; fetare, e shkencore. Në këtë lloj "fajësie", unë këtu fare s'i amnistojë as pseudo intelektualët nga të dy kampet; ai perëndimor, që me naivitetin, paragjykimet dhe keqkuptimet e qëllimshme ka "prodhuar platforma" të atilla që e kanë penguar procesin e rizgjimit dhe ecjes koherente me botën perëndimore. Dhe kampi i myslimanëve, të cilët pak nga joshja me privilegje dhe lakmia kanë bashkëjetuar me vlerat dhe kulturat civilizuese

perëndimore, në dëm të islamit dhe myslimanëve në përgjithësi. Këtu, s'mund e të mos përmend fajësinë e qëllimshme dhe të paqëllimshme të klerit fetar islam, të cilët e kanë interpretuar islamin me metodologji dhe koncepte obskurante të kohërave të kaluara.

Duke, harruar kështu, që islami është tejkohor...dhe se ai s'ishte, s'është, dhe s'do mbetet vetëm për një kohë. Islami dhe myslimanët, sot janë duke përjetuar rëniet dhe stigmatizimet nga më të ndryshme prej që ekziston bota. Dhe që në fillim më duhet ta ceki se, faji për gjithë këtë margjinalizim dhe këndvështrim paragjykues që i bëhet atij sot, fare se fajësoj botën perëndimore, e as islamin si koncept dhe filozofi, ideologji, mënyrë jetese,...apo si të doni mund ta quani! Por, fajin e adresoj pikërisht te myslimanët! Dikush do pyes, si te myslimanët? Ju lutem, ta sqarojë që në fillim të tezës sime, se aludimi im s'ka të bëjë fare me njerëzit, popullin, komunitetin, umetin (apo si të doni quani) mysliman. Myslimanët si komunitet, asnjëherë s'mund t'i fajësojmë për përgjegjësinë që kanë të bëjnë me sferat; sociale, politike, ekonomike, juridike, ushtarake, kulturore...e civilizuese, po, elitat; fetare, e shkencore. Në këtë lloj "fajësie", unë këtu fare s'i amnistojë as pseudo intelektualët nga të dy kampet; ai perëndimor, që me naivitetin, paragjykimet dhe keqkuptimet e qëllimshme ka "prodhuar platforma" të atilla që e kanë penguar procesin e rizgjimit dhe ecjes koherente me botën perëndimore. Dhe kampi i myslimanëve, të cilët pak nga joshja me privilegje dhe lakmia kanë bashkëjetuar me vlerat dhe kulturat civilizuese perëndimore, në dëm të islamit dhe myslimanëve në përgjithësi. Këtu, s'mund e të mos përmend fajësinë e qëllimshme dhe të paqëllimshme të klerit fetar islam, të cilët e kanë interpretuar islamin me metodologji dhe koncepte obskurante të kohërave të kaluara.Duke, harruar kështu, që islami është tejkohor...dhe se ai s'ishte, s'është, dhe s'do mbetet vetëm për një kohë.

Keqkuptimi

Ky lloj keqkuptimi nga ana e ulemave, apo dijetarëve islam, që, dua te besoj se gabimisht e ka interpretuar konceptin fondamental kur'anor të fjalës ***ilm-i*** (që në gjitha gjuhët e botës, e ka kuptimin e dijes, edukimit, e që ndërlidhet edhe me ajetin kur'anor ***"ikre"- lexo, mëso***), pra dijes, që nënkupton një shumësi idesh, kuptimesh, rekomandimesh, dhe prejudikimesh. Në fakt, duhet cekur që ky koncept ***(ilm-i)*** në Kur'anin famëlartë zë një vend

dominues, pas fjalëve ***Allah (Zot)*** dhe ***Raab (Krijues, furnizues)!*** çka nënkupton peshën dhe rëndësinë që Krijuesi i kushton; përpjekjes, obligimit dhe përkushtimit që duhet njeriu t'i kushtoj dijes, njohjes, hulumtimit, gjurmimit të panjohurës..., pra, arsimimit dhe edukimit të çdo kohe! Ose, thënë ndryshe implikimin e idesë për të gjurmuar, meditуar e studiuar gjithë atë që gjendet përreth njeriut, pra, diturinë.[1]***).*** Pra, që në fillim duhet sqaruar, se ***ilm-i,*** ishte dhe mbeti monopol kryesisht i elitave (apo kastave) të dijetarëve dhe klerit islam, e jo e myslimanëve si tërësi demografike, sociale, politike, etj.

Ndërkaq, fjala e Krijuesit famëlartë, dijes i jap një kuptim të urtë e gjithëpërfshirës, ku s'ka monopole, s'ka ndarje dhe të drejta, se kush duhet të injektohet nga dija apo Ilm-i, që dosido, sot duhet të nënkupton; kërkim, komunikim, analizim, interpretim, transmetim...permanent e sistematik në gjitha sferat e jetës (sociale, politike, ekonomike, ushtarake, kulturore, et.)Tani, nëse e thjeshtësojmë tërësisht këtë ekuacion social të përgjegjësisë dhe bazimit në dije, njohuri, metodologji të reja investiguese, etj. na del se islami i mëhershëm si civilizim që kishte çfarë t'i ofronte botës, pra periudhën e kulmimit shkencor, ishte islami i vërtetë edhe për arsye se ;ai s'ishte monopol i një elite të vetme sociale, qoftë ajo fetare, politike, juridike, ekonomike apo kulturore, por, një dije, njohuri, studim, arsimim dhe edukim gjithëpërfshirës i bazuar dhe i respektuar nga të gjithë. " *Poashtu, theksimi i tepërt arsyes ne llogari te besimit intuitiv, e prish jetën e arsyes, duke e reduktuar atë ne :materializëm, utilitarizëm, mekanizëm dhe ne pakuptimësi"*[2]***)***Në kohën tonë, dhe në disa shekuj prapa, kjo mënyrë, ky këndvështrim i proceseve është evidente, se nuk është duke ndodhur... dhe pasojat, po i shohim të gjithë.Interpretimi dogmatik, i dijes (si monopol vetëm për ulemanë!), pra mendimit, arsimimit, edukimit, e ka ndihmuar shumë ngecjen e botës myslimane. Kur, kësaj i shtojmë edhe "ndihmën" që e prodhuan artificialisht dhe metafizikisht këmba dhe apetitet koloniale perëndimore, atëherë e kemi më afër diagnozën e ngecjes dhe prapambetjes së "drejtave të njeriut"[3]***)*** myslimanëve në botë. Përveç, kësaj kjo "ndihmë"

[1] Brill, Leidan. Shih; Al -Ghazalu, The Book of Knowledge,London, 2001

[2] Ismail Faruki, Islamizimi i Diturisë, Shkup, 1999/1420, fq 55.

[3] Konsulto autorin Krzystof Drzewiscki, ku flet për potencialin dhe efektet e ndërkombëtarizimit te Drejtave te Njeriut dhe Legalizimi i tyre, ne: Hyrje ne Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Botuar, nga Raija Hanski & Markku suksi, Prishtine, 2001, fq.40

në një mënyrë apo tjetrën, s' bashku me konformizmin e klerit fetar në vendet myslimane, na dhuroj ekstremizmin, injorancën, fanatizmin, hipokrizinë, fundamentalizmin, islamofobine, padrejtësitë sociale e kulturore, si edhe (çka është më interesant!) hasmërinë e panatyrshme dhe të panevojshme me botën perëndimore! Kur, dimë nga historia e civilizimit kontaktet dhe raportet e shëndosha dhe shumë të hapura me perëndimin (Spanja, Ballkani, etj.). Koha jonë, që ndryshe identifikohet edhe si kohë dhe periudhë e globalizimit, në fakt vetëm sa është duke e ristrukturuar, adaptuar dhe akomoduar këtë digën e mbajtjes në presion permanent të vendeve myslimane.

Sfidat e arsimimit dhe edukimit te islamit

Pa dashtë, të arsyetojë këtë tendencë të re rikolonializuese perëndimore, që botën e arealit islam e trajton kryesisht si "periferi",ndërkaq, vetën si"qendër", më duhet të analizojë pak a shumë projektin e "kontrollit" apo "menaxhimit" (për të mos thënë nënshtrimit!) që ajo i bënë gjithë botës. Projekt ky, që ndihmohet shumë si nga "rezistenca" (tipike naive, e stilit të ksenofobisë; islami ka zgjidhje....,por, pa ofruar asnjë alternativë !) autoktone myslimane, që i bëhet dijes, arsimimit, dhe vlerave perëndimore në përgjithësi.

Edukimi dhe arsimimi, sot në botën islame për mendimin tim, përveç tjerash po ballafaqohet me disa sfida aq interesante, e aq të mjegullta.

Njërën sfidë, që kujtojë se është produkt i stereotipive dhe paragjykimeve që në start i bëhet mënyrës së edukimit dhe arsimimit në botën perëndimore, për gjoja produktet shekullare që s'mund të kooptohen në jetën dhe praktikën islame, për shkak se janë në kundërshtim me vlerat dhe kulturën e komunikimit islam në përgjithësi.

Dhe sfida tjetër, që për mendimin tim gabimisht projektohet dhe identifikohet e kaluara e shndritshme islame (kur pra islami ishte në kulmin e arritjeve të veta, si kulturë dhe si civilizim) si diçka e shenjët, e paarritshme, ideale, pra thënë më thjesht utopike!

Ndërkaq, pak apo shumë pak autorë islam hasi që zgjidhjen e gjithë kësaj ngecjeje e shohin dhe e projektojnë si diçka të ndërmjetme midis këtyre dy sfidave. E ajo rrugë e tretë, apo alternativë që kujtojë do ishte një zgjidhje

shumë më “ekonomike”, në një mënyrë apo tjetrën ka të bëjë me një përpjekje të re për ta humanizuar sistemin vlerorë që ka sa dekada që gjendet në krizë serioze, sidomos në sferën shpirtërore...Pra, cila do ishte oferta serioze islame në këtë konkurrencë globale? Në fakt, unë mendojë që këtë projekt alternativë as që munden dhe as që duhet ta ofrojnë dhe negociojnë kleri fetar, por, elitat e reja shkencore nga të gjitha sferat e jetës. Rilindja e islamit, duhet të synojë një reformim strukturor fondamental, pra, një lloj rizbulimi dinamik të traditës kulmore civilizuese, ku dija, arsimimi ishin alfa dhe omega e gjithë ekspansionit social, politik, ekonomik e kulturor.

Rendi i ri botërorë (globalizimi)

Ne sot, po jetojmë në një botë të globalizuar dhe të dominuar nga vlerat dhe kultura perëndimore. Këtu, s’kemi asnjë dyshim, por, për t'i mënjanuar gjitha ato hipoteka, paragjykime dhe stereotipi që po mundohen t'ia amputojnë islamit (jo myslimane, sepse bota perëndimore s'e ka problemin me myslimanët, por me islamin si; botëkuptim, vlerë, sistem jetese, kulturë dhe praktikë fetare globale, por edhe si konkurrentë civilizues), atij nga vete elitat; kulturore dhe shkencore u duhet një lloj "protestantizmi", pra, një lloj ristrukturimi dhe akomodimi me rrethanat dhe botëkuptimet e reja civilizuese.Ky proces ristrukturues, apo ky lloj "protestantizmi" i brendshëm në vendet dhe shtetet e botës myslimane, s'mund të bëhet nga jomyslimanët, për shumë arsye.

Njëri, që kam bindjen është dominues. E ai ka të bëjë me procesin e ish kolonizimit nga bota perëndimore, që po shihet se kjo "terapi", s'po jap rezultate, por, përkundrazi është duke i shtuar dhe thelluar si paragjykimet, ashtu edhe zbehjen e imazhit ndaj vete islamit dhe myslimanëve në përgjithësi. Pra, ristrukturim nga standardet dhe kriteret jomyslimane, as që mund të imagjinojmë, edhe për shkak se kemi një "testim", apo një metodologji të sprovuar në shekujt e kaluar, kur vendet myslimane ishin koloni të perëndimit.Gjithashtu, një tjetër problematike shqetësuese ka te beje e dhe me kontekstin interpretues qe i behet sot islamit dhe përgjithësisht mësimeve qe dalin nga logjika e interpretimit.

Pra, ka këtu një diskrepancë në masë serioze, që kujtojë se mund të adresohet edhe për faktin se: konteksti i shpjegimit s'është asfare ne koherence me kohën tone, pra shek., e XXI. Konteksti historik, e sidomos ai i idealizuar për se tepërmi, kemi mësuar si leksion se jo gjithmonë është edhe mësim për kohen dhe kontekstin kohor kur shpjegohet apo interpretohet një përvojë e çfarëdo natyre cofte ajo.

Pra mbyllja apo hermetizmi, për te mos me thënë konservimi i interpretimit dogmatik na e ngulfat islamin burimor, nëse, me këtë kontekst burimor nënkuptojmë islamin e praktikuar nga koha e Muhamedit .a.s dhe gjeneratave pasuese te tij.

Keqinterpretimi i Sheriatit

Kjo mënyrë e të gjykuarit për fenomenet, ngjarjet, problemet dhe zhvillimet aktuale, është dëshmuar si tejet e ngurtë dhe pa invencion. Psh. sot shumica e botes myslimane beson që Sheriati (apo jurisprudenca islame), në fakt, është një ligj hyjnor, ndërkaq, në të vërtetë kjo shumice absolute fare se dinë, se ky ligj, ky kodifikim është pjellë (debatesh, konsultash, negocimesh...et.) e mendjeve me të ndritura islame në kohen kur u formulua.

Tani, Legjislacioni i Sheriatit i ndërtuar dhe i legjitimuar në kohën kur kishte motive të bollëkshme që shteti islam të ketë një lloje legjislature sociale, juridike, politik,e ekonomike, e kulturore ishte tejet fleksibil dhe i arsyeshëm, por, koha në të cilën po jetojmë ne, ai duket të mbetet vetëm një"këmishë" shume e ngushtë për nevojat, kërkesat dhe synimet e gjeneratave të internetit, bie fjala!

Shikuar me këtë dioptri, kujtoje islami "i rregullon juridikisht te gjitha raportet përmes Sheriatit"[1]**)** ka mbetur peng i interpretimit të këtij legjislacionit (jo hyjnor, "sepse vetëm Kur'ani është i tillë "[2]**)** dhe"...se ai është i pandare nga jeta e fesë...dhe parakusht esencial për mirëqenie

[1] *Muhamed Kutub, Sa jemi Muslimane, Furkan ISM shkup, 1420/1990, shiko Islami i mire, fq. 50-62*
[2] *Cristian H. Hoffman, I shtrirë nga të gjitha anët, Asr. Tetove, 2003, fq.186*

materiale, morale dhe shpirtërore"[1]*)* në këtë norme legjislative, (thënë më thjesht edhe të një kaluare të artë) ketë tufe legjislative, ne fakt e rizbulojmë paaftësinë tonë për t'u akomoduar me atë tolerancën, hapjen suptile, pra emancipimin e gjithëmbarshëm social, politik, juridik, e kulturor te islamit.

Islami i mirëfillte, në të vërtetë s'guxon fare të mbetet monopol ekskluziv vetëm i elitave të edukuara pamjaftueshëm fetare! Edhe këtë, për disa arsye: njëra, kishte me qene se të njëjtit në mungese të një dije kompatibile, komplementare, e shumëdimensionale bashkëkohore për jetën, ekonominë, historinë, kulturën dhe civilizimin islam do ishin më shume të dëmshme, se sa në dobi të vetë islamit.

Arsyeja tjetër, e këtij lloj "shpronësimi" ka të bëjë me atë se: duke qenë i anatemuar dhe i paragjykuar nga proceset dhe zhvillimet aktuale globale, të njëjtit (pra, elitat ekskluzive fetare!) do zgjonin me shume përbuzje dhe neveri në publik, se sa që do sillnin dobi. Islami nënkupton një kontekst shume më të gjerë dijesh dhe njohjesh, se sa që janë ato religjioze.

A mund te bashkëjetoj islami me sekularizmin?

Sekularizmi, tashmë veç është evidente sociologjikisht si një proces i hapur tipik social, i cili ndjeshëm dhe ne mënyrë te padyshimtë e po ushtron ndikimin e vetë të padiktueshëm. Në fakt, ai është një mënyrë e këndvështrimit se si bota pëson ndryshime(kisha me thënë të pa evitueshme!) sociale, ekonomike, politike, etj., ani pse mund të ndodhë që kjo qasje e tillë të lë gjurmë në formacionet dhe konstruktet mentale të vendeve, shteteve te ndryshme."E ardhmja fatlume e Islamit është kur shkenca te behet krahu me i forte i interpretimit te Shpalljes Hyjnore, te Kur'anit famëlartë....Shkenca, duhet t'i zëvendësoj hamendjet e dijetareve qe bazohen ne shkolla te vjetra juridike disa shekullore dhe analogjitë që shpesh herë janë burimi i interpretimit te manipuluar fetar..."[2]*)*Mund te supozojmë me doza dyshimi, që s'mund të ndodhë që në një shoqëri të mos këtë të instaluar laicizëm (si tek ne psh..neni 8...) e te mos ketë ndodhur

[1] *Ekmeleddin Ihsanoglu, Zapad i Islam, Sarajeve, El Bejan, 2001, fq59-62.*
[2] *Milazim Krasniqi, (2007), "Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore", Zëri Ynë, fq.138*

procesi i sekularizimit paraprakisht! Pra, nëse nisemi nga etimologjia e fjalës për këtë termë që sot në botën moderne është familjarizuar aq shumë, atëherë sekularizmi, në fakt përfshin jo sistemin e të menduarit dhe gjykuarit kolektiv të një shoqërie, por vetëm sferën e religjionit, ku ai si imperativ të qëllimshëm e ka ridefinimin e praktikave të një vendi që ka psh. probleme të mëdha identitare, sidomos, në periudhën e transformimeve.Andaj, varësisht nga ajo se cili drejtim ideologjik do te dominoje, "do afirmohet ideja e islamit te hapur, bashkëpunues, jo konservativ dhe tejet koherent me zhvillimet aktuale globale, ose islamit retrograd, totalitarizmit politik apo islamit të vetëmjaftueshëm kulturor"[1]*).*Andaj, kujtojë që e ardhmja e islamit qëndron pikërisht në bazamentet shkencore, pra, kur dija dhe shkenca do bëhen krah i djathtë i Shpalljes Hyjnore, të Kur'anit famëlartë, e jo, ideologjive dhe formacioneve të ndryshme të çfarëdo natyre qofshin ato.

Një milion pyetje e (as) një përgjigje në planin (gjithë)kombëtar!

Një milion pyetje e pakë përgjigje, është një Projekt gjithëkombëtar i cili duhet të shtrihet kujtojë në dy rrafshe: Njërin, siç e quaj unë të brendshëm dhe që ka të bëjë gjithsesi me proceset, problemet, dilemat, sfidat dhe mënyrën se si ne së bashku me shteti shqiptar, Shqipërinë duhet t'i sinkronizojmë në kuptimin e formimit të një qëndrimi të vetëm dhe unik në përballje me proceset tjera globale, e thënë më qartë proceset integrative evropiane.Rrafshi tjetër që kërkon padyshim një agjendë dhe përkushtim tjetërfare edhe me faktin se kriteret dhe standardet nuk i caktojmë ne por institucionet në ngritje të BE-sNdërkaq, çështja më e rëndësishme në gjithë këtë debat që kujtojë në kohë dhe moment të duhur duhet të bëhet edhe publik, ka të bëjë me dilemën se si duhet ta shpejtojmë ritmin e proceseve në fjalë?

Pra, a mund të bëhen pengesa serioze çështja e mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana pesë vendeve evropiane në këtë rrugëtim, a kemi mjaftë kapacitete administrative për t'i përmbushur të gjitha obligimet dhe kriteret strikte teknike të parapara nga BE-ja për çdo vend para se të anëtarësohet

[1] *Fikret Karcic, Razumevanje Islamskog vjerozakona, (Sheriata) u Suvremenom Muslimanskom Svijetu, që mund te gjendet ne: Islamski fundamentalizam, Sta jo to, i përgatitur nga Nusret Cancar & Enes Karic, Sarajeve, 1990, fq.40.*

në këtë konstrukt të ri? A ka ide se si duhet të gjendemi në rast se ky projekt integrues dështon, cilat opsione dhe plane rezervë duhet t'i ketë në tavolinë Kosova? A ka debat se duhet të hyjmë si Kosovë apo si të bashkuar (me Shqipërinë) në një shtet në BE?Çka e pengon debatin e kësi sojit në nivel politikë, cilat janë ato pengesa lokale dhe sosh globale? Çfarë kapacitetesh politike, ekonomike, sociale e kulturor duhet të ndërtohen në ndërkohë?

A ka përllogaritje se është më mirë të integrohemi ndaras si dy shtete apo si një shtet i vetëm unik në Ballkan?
Nëse duhet t'u paraprijë këtyre proceseve të brendshme integruese midis dy shteteve aktuale? Janë elitat politike, ato ekonomike apo ato kulturore? Sa kohë marrin ato? Çfarë kostoje ka i gjithë ky projekt i integrimit të brendshëm? Në këtë rrugëtim të integrimit të brendshëm a ka dhe cilat janë ato sfida të cilat në bazë të një eksplorimi empirik munden eventualisht të bëhen pengesa të pa kapërcyeshme në proceset tjera integruese evropiane? Pastaj, cilat interesa lokale përputhen me interesat globale dhe si mund t'i materializojmë në nivel gjithëkombëtar këto interesa, në mënyrë që të mos përsëritet sindromi historik i ngecjes dhe anatemimit nga të tjerët? Cilat potenciale ushtarake, duhet ta fuqizojnë idenë sigurisë dhe mbrojtes së ...
Me çfarë agjende: politike, ekonomike, ushtarake e kulturore duhet t'i joshim dhe afrojmë interesat e lidershipit botëror në këtë pjesë të Ballkanit? A duhet të kemi edhe planin B-e, në rast të kontestimit të këtij Projekti (mbarë)kombëtar?... E një milion pyetje, çështje e dilema që lipsen të kenë përgjigje të duhur, në momentin e duhur dhe vendin e duhur...

Gjithashtu, çështje që kujtojë se duhet të debatohej apo të paktën të futet ndoshta në agjenda të politikës shkaku i dinamikës së proceseve që mund të ndodhin në ndërkohë me një shpejtësi marramendëse, është padyshim edhe ajo se si t'u shpjegohet i gjithë ky projekt dhe ide qytetarëve? Unë këtu nuk aludojë në mënyrën e propagandimit, por në hapat e domosdoshëm (*elementarë*) që duhet ndërmarr në këtë drejtim, në mënyrë që ata ta kuptojnë dhe ndjejnë interesin e tyre jo vetëm ekonomik, por edhe social e kulturorë.

Një tjetër pistë investigimi padyshim që kujtojë se duhet orientuar edhe kah subkulturat e politikave dhe institucioneve ekzistuese, të cilat pa fajin e tyre kanë pak apo aspak informacione lidhur me: procedurat, mënyrën, formën, përmbajtjen dhe efektet dobiprurëse për vendin që mund të ofrojnë procesi i integrimeve evropiane. Këtë detyrë të "njohjes" apo furnizimit të parlamentarëve të ardhshëm, si edhe institucioneve tjera, do të duhej ta marrë përsipër shoqëria civile përmes organizimit të tryezave, konferencave si edhe shtypjes së broshurave, dhe mënyrave tjera senzibilizuese e lobuese.

Mendojë definitivisht që Kosova u takon atyre shoqërive të rralla dhe padyshim edhe të fundit politike në Evropë, ku gati të gjitha çështjet fundamentale për t'u bë' një shoqëri normale, janë të hapura...Për Shqipërinë kujtojë që duhet një skanim tjetërfare, ngase atje demokracia dhe ndertimi i shtetit filluan me heret dhe natyrisht qe edhe prodhuan procese e zhvillime socio-kulturore me specifike.

Kur po e beja gati per botim kete shkrim, një kolegë më tha se shkrimet e mija kryesisht po merren vetëm me diagnoza të shoqërisë sonë, por jo edhe me terapia..Përgjigja ime ishte, dhe akoma mbetet se puna e terapisë na takon vetem aq sa ne i pushtojme dhe i "pronesojme" ato ne menyre qe t'i fusim ne funksion te synimit te lartecekur per integrim ne Evrope. Sa kisha të drejtë, le të gjykojnë lexuesit dhe kompetentët së bashku me ata që janë "pronarë" të vërtetë të këtij Projekti?!

E vërteta shkencore mbi "të vërtetën" islamofobe

Është një thënie e njohur diku që thotë se ;"Urrejtja ndaj islamit po bëhet gjithnjë më e madhe se sa dashuria ndaj demokracisë (!), ose, dashuria ndajë demokracisë, po bëhet gjithnjë më e vogël, se sa urrejtja ndaj islamit"! Gjithashtu, edhe një tjetër që thotë; "Largohuni nga ekstremizmi në fe, sepse ekstremizmi dhe pamaturia në fe i kanë shkatërruar ata që kanë qenë para jush"!Qytetarët e rëndomtë shqiptar nuk kanë ndonjë arsye të theksuar që t'i frikësohen islamit burimor, ose, nuk kanë arsye ta urrejnë islamin si fe me parime dhe fondamente monoteiste, paqësore! Ngase, çështja e cilitdo besim mbrohet, garantohet dhe kategorizohet me legjislacion dhe me Kushtetutë dhe me ligje. Ata, kanë arsye shumë më

tepër që t'u frikësohen interpretuesve injorant, medieve dhe rrjeteve islamofobe, e sidomos mercenarëve të frustruar islam e joislam!!

Në kushtet dhe rrethanat e disa proceseve dhe zhvillimeve globale, paragjykimi i islamit si fe monoteiste (s 'bashku me krishterimin dhe judaizmin), sot në mediet globale dhe rrjetet sociale, është në rritje e sipër! Ajo çka është më shqetësuese, është fakti që interpretimet nuk po bëhen nga ekspertët profesional dhe njerëzit kompetent të fushave dhe lëmive përkatëse, por nga mediokret medial, pastaj islamofobët dhe grupet e ndryshme dogmatike të proveniencës islame dhe joislame.

Natyrisht, interpretimet e tilla jokompetente, sjellin edhe stigmatizim e stereotipizim që e vështërsojnë depërtimin e vizionit paqësor të islamit të vërtetë! Dhe si pasojë i gjithë këtij "mobiliteti" dosido antiislam, paraqitën edhe tendenca monopoliste mbi të "vërtetën" e vërtetë islame! Thënë me thjesht, paraqitën devijime apo ekstremizma të të gjitha llojeve dhe ngjyrave. S'këndejmi, këtyre tendencave nuk mund t'u ikin as shqiptarët e Ballkanit, e as boshnjakët që rastësisht apo jo rastësisht mbetën mysliman me përkatësi fetare!Tani, koha e globalizimit (si më tha një mik një ditë: "na çoroditi" krejt!?) është e vërtetë kohë që ka prodhua shumë armiq dhe shumë mundësi të keqinterpretimeve, për këto religjione monoteiste, e në veçanti për islamin! Shqiptarët, s'ka shans që të implikohen në këto "lojëra" morbide dhe të qëllimshme globale, për një arsy shumë të thjesht: ndjenja kombëtare gjithnjë ka qenë shumë më e fortë se ndjenja fetare. Por, ata fakt që do atakohen edhe për një kohë me stigmatizime e paragjykime nga më të ndryshmet, si nga "qendrat" islamofobe, ashtu edhe nga mediokritetet mediatike, te cilat të frustruara dhe të frymëzuara nga trendet globale, përpiqen t'i konfrontojnë gjëja "dallimet" fundamntale midis religjioneve monoteiste!Midis këtyre qendrave "islamofobe dhe jo islamofobe", padyshim që sot më të "afirmuarit" dhe më të zëshmit në sferën e sigurisë politike e sociale, e sidomos kulturore janë ata që ndërlidhen me termat, e ekstremizmit dhe terrorizmit. Ekstremizmi, si një platformë sociopolitike dhe padyshim edhe fetare, në fakt ka të bëjë me grupe të atilla sociale, politike e edhe fetare, të cilat kanë probleme serioze me identitetin e tyre të luhatur, kontestuar, apo edhe tē humbur për shkaqe të ndryshmet sociale, politike, kulturore, e civilizuese!

Në fakt ideja apo synimi i njeriut, që nga fillimet e hershme sociopolitike ishte dhe mbetet ai i "vetëkërkimit", për origjinën e tij, se kush është ai, prej nga vjen, dhe ku shkon? Një synim identik i "vetëkërkimit", duket se ka të bëjë edhe me grupet, komunitetet, kombet, bile bile edhe religjionet e shtetet (e reja sidomos!)! Pra, imitimi apo identifikimi i shteteve (të reja dhe të vogla sidomos!), me shtetet e mëdha dhe me influencë globale, është pothuajse normal dhe i dukshëm edhe në kohën tonë. Kjo vlen posaçërisht për SHBA-es, Rusinë, Kinën dhe Indinë. Në këtë proces "vetëkërkimi" identitar, pësojnë më së shumti vendet dhe shtetet e ndara (padrejtësisht e historikisht), shtetet e varfra, ato me territor të vogël, e sidomos vendet dhe shtetet që kanë pozitë strategjike në këmbimet, tregtare, sociale e kulturore.

Andaj, pakënaqësitë, mospajtimet lidhur me mënyrat e krijimit të raporteve (lexo; varësive të reja; ekonomike, politike, civilizuese dhe sosh kulturore)është e natyrshme të sjellin edhe mendime dhe gjykime "laramane" në (mos)kyçjet e reja me hegjemonët e kohës! Si pasojë, lindin edhe pozicionohen grupe të pakënaqura me këto procese e rrjedha; lokale, rajonale, kontinentale e globale. Për të kuptuar më mirë këto trende global, mendoj që është e udhës të shohim se cka po (nen)kuptohet psh. me termin apo konceptin e shpërndarë dhe të njohur gjithandej në glob.Çka është fundamentalizmi islam? Nëse, dëshirojmë t'i japim një përgjigje tipike shkencore sociologjike, atëherë patjetër që: fundamentalizmin islam duhet shpjeguar edhe si reagim ndaj krizës së identitetit të krijuar nga (post)modernizmi, ndaj tepricës së shoqërive konsumatorizmit, ndaj pafuqisë së imponuar nga padrejtësitë strukturore dhe liberalizimit global të tregut. Faktikisht dhe fatkeqësisht, këtë Íloj fundamentalizmi (se janë prezent ne skenën globale edhe të tjerët…por, me pak gjithsesi) po e "ushqejnë" ekspansioni marramendës i tregut, (që rezultoi me kolapsimin e komunizmit dhe rënien e Murit të Berlinit), dhe interpretimi i fragmentarizuar që i bëhet islamit të sotëm.

Duke shikuar, nga ky këndvështrim islami burimor, po bëhet apo të paktën pretendohet të imponohet, jo më si kundërshti ndaj perëndimit, por, si alternativë globale sociale e politike.Ndërkaq, duhet ditur dhe kuptuar që diskursi mbi fundamentalizmin islamik, në fakt në tregun global, është vetëm një katërpërcishi i asaj që është në të vërtetë. Këtu, para së gjithash

s'duhet harruar joshjen që mund ta krijojë në të ardhmen rreth temave mbi; egalitarizmin, përgjegjësinë rreth diversitetit (social, ekonomik, etnik, racor, etj.); konsultimin dhe konsensusin; etj. që realisht i bie një ngatërrim (herë e qëllimshëm, e herë i paqëllimshëm!?) midis asaj që shquhet si edukim fetar dhe histori fetare te religjioneve!

A janë njëjtë edukimi fetar me historinë fetare, dhe pse po ndodhë terrorizmi?Duhet kuptuar digresionin se; edukimi mbi etnopsikologjinë fetare dhe çështjet e fakteve rreth historive fetare, nuk janë e njëjta gjë! Ngatërrimi, i këtyre dy kategorive, përveç keqkuptimit social, sjell edhe trauma në sferën shpirtërore (diversitet dhe ndarje kompleksive) dhe pasoja në sferën politike (paragjykime dhe stereotipizime absurde). Ato do ndikojnë edhe më tej në formimin, brumosjen dhe kalitjen e secilit i individ, edhe për shkakun se njeriu vërtetë akoma mbetet një "zoom politikom", social që vulos të tashmen dhe të ardhmen e vetë…., pandalur! Terrorizmin nuk e provokon aq shumë feja, sa e bënë atë ekspansioni i grykësisë së kapitalizmit grabitqar, dhe shërbimet militante të grupeve mercenare që janë në shërbim të dominim (kaosit!) global! Pra, kur kërkohen terroristët, thjesht, duhet të kërkohen njerëzit që blejnë armatim të dyshimtë terrorist, e jo sish që i luten me sinqeritet Krijuesit! ….!Ky termë, si dukuri dhe fenomen sociologjik, është edhe një forme tejet e komplikuar e "trajnimit"të dhunës politike. Për te thuhet që është edhe një lloj ekstremizmi me doza politike! Kurse, ekstremizmi më saktë, mund të definohet si një lloj sjelljeje e atillë sociale që "vegjeton", gjithnjë midis asaj që është e lejuar dhe asaj që është e sanksionuar!Pra, ai është sikur një lloj "parakalimi" mbi një zonë të "minuar"! Për nga numri, ekstremistêt asnjëherë nuk janë shumë, por, janë zhurmues dhe fanatik në qëllimet dhe synimet e tyre! Çfarëdo qofshin, dhe prej kujtdo qofshin, ato! Në politikë, ekstremizmi zakonisht manifestohet si "një lloj animimi i qëllimeve të kornizuara ekstreme, që pretendon gjithnjë të fuqizohet përmes metodologjive normale! Në fakt, ekstremizmi mund të thuhet dhe definohet edhe si një lloj devijimi i skajshëm, edhe për shkak se "vullnetarisht" ikën dhe sistemohet në normat sociale, sportive, politike, e sidomos ato fetare.

Ajo çka i jep "shpirt" dhe karakter fenomenit, apo "dosjes" së ekstremizmit janë kryesisht motivet dhe qëllimet politike! Motive dhe qëllime këto, që

me karakterin e tyre politik, ekstremizmin e katapultojnë drejtpërdrejt në fushëbeteja dhe ngjyrime; fetare (monoteiste) e ideologjike (djathtiste e majtiste). Ekstremizmi ideologjik, një rrezik për religjionet monoteiste Tani, ekstremizmi ideologjik djathtist (ai fetar), e kundërshton globalizimin shkaku ruajtjes dhe konservimit të fondamenteve fetare; kurse, ekstremizmi majtist (ai social komunist), globalizimin e projekton si gogol, edhe shkaku i rrezikut nga varfëria…! Kështu që procesi i "vetëkërkimit", është kogja kompleksiv dhe shumëdimensional. Kompleksiv, shkaku se problemet identitare shpërfaqën tani si probleme akute, që kërkojnë urgjenca definimi dhe qartësimi! Kurse shumëdimensional, shkaku se dilemat ekzistuese civilizuese, tek këto vende e shtete të vogla, dhe të varfra, bëhet shpeshherë problematik dhe i rëndësishëm si për "sponzoruesit dhe arkitektët" e pavarësimeve dhe shteteve që u jepet peshë dhe rendësi, qoftë rajonale (Ballkani) apo kontinentale (Azia). Kështu që "krizat" identitare të stilit; "kush jemi ne, prej nga vijmë, dhe ku shkojmë", edhe si shtet, vend e komb, sot janë përditshmëri!

Sipas Samuel Huntigtoni, kjo gjendje dhe "krizë" identitare, mund të tejkalohet përmes disa mënyrave. Përmes ndihmës së institucioneve shtetërore, elitave (politike, ekonomike, e kulturore),dhe natyrisht popullsia, e cila duhet të informohet për nevojat, detyrimet dhe kahet e ndryshimeve eventuale, si edhe ndihma nga perëndimi (aludimi është; Amerika dhe Evropa). Duhet kuptuar që integrimet evropiane korrespondojnë me proceset globalizueseNevoja për një epistemologji sociale të religjioneve monoteiste Nëpër shkolla publike, sot në botën postmoderne, s'duhet të mbetet më një cilësim paragjykues dhe tentim stigmatizimi për religjionet monoteiste, ashtu siç ishte, apo edhe është aktualisht, në pothuajse shumicën e vendeve të tranzicionit, por, është një nevojë imediate e kohës në mënyrë që t'i shmangemi fundamentalizmave, ekstremizmave dhe terrorizmave të të gjitha llojeve dhe niveleve.

Përvoja evropiane na dëshmon se njohjet shkencore (e jo ato pseudo-shkencore) të historive të religjioneve monoteiste (një sferë goxha komplekse dhe e ngarkuar shpesh edhe me klishe pseudo-ekumenike) janë treguar si të shëndetshme edhe për faktin se, mes tjerash, a) kanë zbutur mendjet paragjykuese, b) kanë shëruar patologjitë sociale, dhe c) kanë

reduktuar frustrimet e individëve, grupeve, komuniteteve, por edhe të popujve dhe shteteve të ndryshme evropiane. Pra, kjo iniciativë assesi s'duhet kuptuar dhe interpretuar si tentim për të futur "mësim besimin fetar" nëpër shkolla publike, por si një koherencë kulturore, pra si një njohje ndërfetare midis religjioneve dhe si përvojë e qëndrueshme, ku përmes njohjeve reciproke ndërtohen urat mes feve, konfesioneve, racave, civilizimeve dhe kulturave.

Mosnjohja apo mosdija e religjioneve për njëri-tjetrin s'është përparësi, por, pengesë që ka prodhuar, po prodhon dhe do të prodhojë pasoja negative në njerëz dhe të mira materiale, si edhe një frustrim deri në nivel kontinental e global! Kjo, tanim prodhon padyshim edhe fenomenin tjeter aktual e me përmasa globale, te shquar dhe te identifikuar si terrorrizem."Terrorizmi; nuk ka as komb, as shtet, as … e as fe…! Bota në të cilën po jetojmë ne shquhet si botë e rrezikshmërisë (*Risikogesellschaft) së shkallës së lartë!" (Ulrich Beck, Risk Society, 325.2009*) 22. Dilema "hamletiane" për mendimin tim qëndron në atë se: a duhet ne nga pragu ynë lokal ta refuzojmë dhe ta kundërshtojmë këtë të keqe (gjë që jam tërësisht dakord!), që ka marr përmasa të paparashikuara, apo, duhet të mësohemi të "bashkëjetojmë"me te?Përgjigjen (lidhur me terrorizmin)… po e ka problem e gjithë bota ta gjej! Problemi, (tek shumica e sociologëve bashkëkohor, te paktën çka kam mund ta shoh) qëndron të shkaqet e tendencës së dominimit, eksploatimit, ndryshimit, imponimit, subordinimit të kombeve,feve, shteteve, vendeve, rajoneve, kontinenteve…

RËNDËSIA E TOLERANCËS FETARE NË SHOQËRITË MULTIKONFESIONALE DHE MULTIETNIKE

Fahrush REXHEPI
Fakulteti i Studimeve Islame – Prishtinë, e-mail: fahrush.rexhepi@msn.com

Abstrakt

Tema "Rendësia e tolerancës fetare në shoqëritë multikonfesionale dhe multietnike" ka për qëllim hulumtimin, analizën dhe rolin e tolerancës fetare në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale në Maqedoninë e Veriut në të cilën jetojnë disa komunitete si; maqedon, shqiptar, turq, boshnjak, vlleh, serb, rom etj..

Ideja e ndertimit të paqës dhe tolerancës në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale zakonisht mirret si moster apo si model nga disa vende demokratike te botës perendimore. Mirëpo, ne mendojmë se edhe roli i feve dhe toleranca fetare është mjaftë i rëndësishëm në vendet dhe shoqëritë ku jetojnë komunitetet e ndryshme fetare dhe etnike.

Toleranca dhe dialogu mes popujve dhe shoqërive me diversitete të ndryshme kulturore dhe fetare është në të vërtetë synim dhe një sfidë për të gjitha shoqëritë e rajonit te Ballkanit, por edhe më gjerë. Prandaj, angazhimi i institucioneve fetare, angazhimi i institucioneve akademike shkencore, në këtë rast edhe i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup në zhvillimin e proceseve të paqes, tolerancës dhe të dialogut ndërfetar, politik dhe shoqëror, mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërisë jo vetem në Maqedoninë e Veriut, por edhe në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës në përgjithsi.

Fjalët Kyq: Tolerancë, multikonfesionale, shoqëri, analiz, fe.

Ekzistimi i shoqërisë multietnike në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut – përceptimet

Historia nëpër të cilën ka kaluar Maqedonia, Kosova, Serbia, Bosnja dhe disa vende të tjera të Ballkanit si dhe popujt e tyre, e sidomos rrethanat pas luftrave të fundit, në këto shtete, kanë krijuar ndasi të mëdha mes komuniteteve, me theks të veçant në mes atij shqiptar dhe serb dhe atij shqiptar dhe maqedon.

Pas përfundimit të këtyre konflikteve dhe krijimit të stabilitetit me ndërmjetsimin e faktorëve ndërkombëtar, njëra nga temat më të përfolura në 20 vitet e fundit ka qenë shoqëria multietnike, multikonfesionale dhe bashkjetesa mes të gjithë komuniteteve.

Sa i përket Maqedonisë Veriore, pas luftës dhe represionit maqedonas ndaj shqiptarëve një pajtim dhe bashkjetesë dukej pothuajse e pamundur. Konflikti, viktimat dhe sulmet e herë pas hershme të grupeve të të rinjëve maqedonas ndaj qytetarëve të nacionalitetit shqiptarë në Maqedoni dhe rasti i Kumanovës, kërkojnë kohë, mund dhe sakrificë për ngritjen e një shoqërie paqësore multikonfesionale dhe tolerante. Megjithatë mendojmë se ekzistojnë rrugë dhe mënyra në tejkalimin e këtyre pengesave.

Përceptimet rreth shoqërisë multietnike në Maqedoninë e veriut mendojmë se janë relativisht të sakta. Në Maqedoninë Veriore ekzistojnë komunitete të ndryshme me gjuhë, kulturë, prejardhje, religjione dhe tradita të ndryshme. Përveç dy nacionaliteteve më të mëdha ai maqedonas dhe shqiptar në këtë shtet jetojnë edhe etni boshnjake, turke, serbe, vllehe ,rome etj.

Kjo shoqëri me disa etni në vendet e zhvilluara demokratike konsiderohet, si një shoqëri e ngritur mbi vlerat njerëzore dhe demokratike. Mirëpo, për të ekzistuar një shoqëri e tillë mbi themelet e një shoqërie të shëndoshë, duhet ndërtuar paqën, tolerancën, mirëkuptimin dhe përmirësimin e kohezionit në shoqëri. Për disa si dhe për bashkësinë ndërkombëtare, shoqëria multietnike ndoshta nënkupton shoqëri dyetnike, maqedonasit dhe shqiptarët, ndërsa etnitetet tjera nuk konsiderohen si etni me përparsi të barabarta.

Në Maqedoninë e Veriut edhe pse ndonjëherë ekzistojnë ndasi në mes të komuniteteve, sidomos në mes atij maqedonas dhe shqiptarë, është e mundur të ketë bashkjetesë dhe paqë nëse edhe shqiptarët i gëzojnë të drejtat e tyre të barabarta me maqedonasit.

Për sa i përket Kosovës, ekzistojnë mendime te ndryshme nese Kosova është shoqëri multietnike dhe multifetare. Edhepse Kosova zyrtarisht konsiderohet shoqëri multietnike dhe multifetare ngase në të jetojnë një numër i nacionaliteteve dhe i komuniteteve të ndryshme fetare, megjithatë dihet mirëfilli se në Kosovë jetojnë mbi 90% shqiptar dhe mbi 95% musliman që do të thotë se praktikisht Kosova nuk është shoqëri multietnike dhe multikonfesionale. Sipas Esat Stavilecit "Kosova nuk përbënë mozaik nacional" (Esat Stavileci, 2008). Në Kosovë edhepse ekzistojnë ndasi të mëdha në mes të komuniteteve, sidomos në mes atij shqiptar dhe serb, është e mundur të ketë bashkëjetesë, nese serbët e Kosovës e kuptojnë realitetin e ri në Ballkan dhe nëse ata e konsiderojnë veten e tyre si qytetarë të barabartë me të tjerët.

Vlera e shoqërisë dhe bashkëjetesës të të gjitha komuniteteve, konsiderohet një faktor i rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë, si dhe në shtetbërjen dhe shtetndërtimin e Kosovës. Shoqëria e shëndoshë dhe tolerante multikonfesionale dhe multietnike është imperativ për stabilitet politik qoftë në Kosovë apo Maqedoninë Veriore, kur ajo e kupton rolin dhe pozitën e saj qoftë shoqëria shumicë qoftë shoqëria pakicë. Nëse secila nga komunitetet e kuptojnë pozitën e tyre të barabartë , atëherë do të arrihet një besim i ndërsjellë mes të gjitha komuniteteve.

Kjo krijon mundësinë për zhdukjen e konflikteve ndëretinike, ndërkonfesionale sepse "njerëzit nuk mund të bashkohen lirisht për të mbeshtetur synimet e tyre pa pasur njëfarë besimi te njëri tjetri" (Robert A, Dahel. 2005). Me siguri që promovimi i barazisë dhe i tolerancës ndërfetare dhe ndëretnike mundëson progresin dhe integrimin në këtë rast të Kosovës dhe Maqedonisë në strukturat euroatlantike dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Gjithashtu mundëson rritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike. Një shoqëri e tillë është kusht për konsolidimin e demokracisë, veçmas në rajonin e Ballkanit të trazuar nga luftërat sepse "institucionalizim i arenave për dialog e diskutim mes shumicës së

shoqërisë dhe pakicave, është elementi më i qartë i kuptimit demokratik…" (Knut Midgaard, Bjorn Erik Rasch. 2008).

Për ta mbajtur në paqë dhe në harmoni një shoqëri multietnike dhe multikonfesionale, duhet të jenë të garantuara të drejtat e komuniteteve me kushtetutën e vendeve në të cilin jetojnë ato, e veçmas kjo vlenë për Serbine e cila gjithnjë e më tepër poi diskriminon shqiptarët e Luginës së Preshevës, si dhe pakicat tjera që jetojnë atje.

Toleranca ndërfetare dhe ndërtimi i paqes

Përveç shkrimeve të shumta dhe publikimeve nëpër gazeta e revista të ndryshme dhe përveç veprave shkencore që janë shkruar lidhur me tolerancën, paqen, lirinë e bindjes politike, lirinë e përcaktimit fetar, për këto tema diskutohet edhe në shumë simpoziume, konferenca, sesione shkencore dhe në shumë programe të mediave elektronike vizuele. Një nga shprehjet e shpeshta dhe të zakonshme që sot përdoret edhe nga studiues të ndryshëm edhe nga liderët politik dhe ata fetarë, është tolerance ndërkonfesionale dhe ndëretnike. Me vetë faktin se kjo shprehje përdoret sot aq shpesh, na bënë të kuptojmë se ky problem ende nuk është tejkaluar, jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por edhe në vendet e tjera të Ballkanit apo shoqëri tjera të botës së shekullit 21.

Tani të shohim se çfarë nënkuptojmë me nocionin "tolerancë". Në fakt kjo është një shprehje, e cila rrjedhë nga fjala latine "tolere", e që ka përkufizimin e durimit, mirëkuptimit dhe zemërbutësisë ndaj mendimeve të të tjerëve. Në gjuhën arabe apo në literaturën islame për shprehjen tolerancë përdoret fjala "tesamuh", e cila për nga përmbajtja ka një kuptim më të gjerë dhe më gjithë përfshirës. Në tolerancën islame nuk ekziston ajo që njeriu të detyroj vetveten, por që njeriu të pranoj dhe të pajtohet me realitetin. Islami dhe detyrimi sikur dhe islami e dhuna janë në kundërshtim njëri me tjetrin, janë dy pole të kundërta të realitetit botërorë.

Nëse i analizojmë dhe i zbërthejmë mirë burimet kryesore të fesë islame, kur'anin dhe traditën profetike, do të shohim se që të dya këto burime me normat dhe rregullat e tyre në mënyrë reale trajtojnë qështjen e tolerancës dhe të bashkjetesës ndërmjet besimtarëve me përkatësi të ndryshme fetare dhe nacionale. Në vazhdim do ti citojmë disa ajete

kur'anore në të cilat theksohet qartë liria e besimit, si ajeti; "Thuaj: e vërteta është nga Zoti juaj, prandaj kushdo le të besoj, kushdo le të mos besoj". (El-Kehf, 29).

Koncepti i tolerancës ndaj besimeve të tjera vërehet edhe në ajetin tjetër, në të cilin thuhet; "Ti këshillo, ti je vetëm këshillues. Ti ndaj tyre nuk je detyrues". (El- Gashje, 22-23).

Islami nga besimtarët e vet jo vetëm që kërkon dialog, tolerancë, mirëkuptim me pjestarët e feve tjera, por ai shkon edhe më larg dhe nga tolerance kalon në shkallën e njohjes, që është shkalla më e lartë e tolerancës dhe garanci për bashkjetesë në mes shoqërive multikonfesionale dhe multinacionale. Kur'ani si libër hyjnorë që të tri fetë i quan fe qiellore dhe i fton për bashkpunim me këto fjalë: "O ithtarë të librit ejani të bashkohemi (të dialogojmë) rreth gjërave të përbashkëta edhe për ju edhe për ne: të adhurojmë vetëm një Zot e mos t'i bëjmë asnjë shok Atij dhe mos ta marrim njëri-tjetrin për Zot, në vend të Perëndisë". (Ali Imran, 64).

Në lidhje me tolerancën në traditën profetike, Muhamedi a.s. si interpretues ligjitim i kuranit, më së miri i sqaroi parimet dhe idealet e larta kuranore, që kanë të bëjnë me tolerancën, drejtësinë dhe lirinë e besimit. Ai me shembullin e vet i bëri traditë praktike këto parime dhe u bë model edhe për brezat e ardhshëm. Ai kishte thënë: "Drejtësia mbanë qiellin dhe tokën".

Roli i fesë në shoqëri

Roli i fesë dhe kontributi i bashkësive fetare si dhe bashkpunimi i tyre me institucionet publike shtetrore në ndërtimin e paqes dhe te tolerances dhe në zhvillimin e proceseve multikonfesionale, multinacionale si dhe në ato politike dhe integruese në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit, është shumë i rëndësishëm dhe mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërisë së këtyre vendeve dhe një përgjegjsi sa fetare e humane po aq edhe politike e shtetrore për të cilat ka nevojë çdo vend.

Edhe në ligjërimin politik e akademik perëndimor hasim pikëpamje të shumta mbi natyrën, vendin dhe rolin e fesë në botë në përgjithësi dhe të islamit në veçanti, për sa i përket aspektit politik dhe zgjidhjes së konflikteve. Së pari më janë dukur më të përshtatshmit dhe më interesante dy vlerësime. Njëri është i kryerabinit të Anglisë, dr.Xhonatan Soks, i cili ka thënë: "Feja është bërë forcë madhore në formësimin e ngjarjeve në botë dhe nëse nuk është pjesë e zgjidhjes, është me siguri pjesë e problemit".

Ndërsa vlerësimi tjetër është i ish presidentit të SHBA-ve, Xhimi Karter, i cili është shprehur: "Vitet e fundit besimi fetarë ka hyrë në një shkallë të pabesueshme në mbretërinë e politikës…dhe se …ka një prirje drejtë fundamentalizmit në të gjitha fetë". Ideja se teologjia ndikon shumë në politikën shtetrore amerikane është objekt shtjellimi edhe në 400 faqet e librit të Kevin Filips me titull "American theocracy", 2006 (Teokracia Amerikane).

Ne mendojmë se bota sot, por edhe shoqëritë tona në Ballkan kanë nevojë për energji fetare, të cilën shumë vende po e shfrytëzojnë ngase laicizmi është treguar i pasuksesshëm në zgjidhjen e problemeve shoqërore e veçmas atyre morale e shpirtërore.

Këtë e vërteton fakti i pa kontestuar se sot bota posedon pasuri dhe të mira material më shumë se kurrnjeherë më parë, por aq sa të shtohen begatitë dhe të mirat material aq më shumë shtohen pasiguria dhe rrezikimi i paqes. Pra, gjykohet kështu ngase besimi i pastërt dhe i sinqert në Krijuesin e gjithsisë është i vetmi burim, i cili te individi dhe shoqëria prodhon pa ndërprerë paqe, qetësi dhe stabilitet. Lidhur me këtë një citat kur'anor thotë: "Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurtë dhe ata janë në rrugë të drejtë".

Se feja dhe liderët fetarë mund të kontribojnë në ndërtimin e paqes dhe promovimin e tolerancës tregon edhe fakti i vizitës së Papës para dy viteve në Egjipt dhe takimi i tij me Shejhin e Ez-harit në Kajro. Takime të tilla të liderve fetarë janë të shumta edhe në vendet e Ballkanit sidomos ato që kanë qenë të përfshira në luftë në fund të shek.20 dhe në fillim të shek.21.

Ne që vijmë nga Kosova e dijm se gjatë luftës së fundit para dhe pas saj janë zhvilluar dhjetra e dhjetra takime të liderve të komuniteteve fetare muslimane, katolike dhe ortodokse. Qëllimi i këtyre takimeve gjithëherë ka qenë pajtimi, tolerance, zgjidhja e konflikteve dhe ndërtimi i paqes. Në këtë drejtim shpeshëherë janë organizuar konferenca shkencore, sesione, debate etj. Fatkeqësisht më duhet të them se kisha ortodokse serbe jorrallëherë ka bojkotuar dhe ka qenë indiferente ndaj zhvillimeve dhe organizimeve të tilla.

Sa i përket shqiptarëve edhepse populli shqiptarë është i ndarë në dy konfesione e disa rite, historia nuk mbanë në mend të kenë ndodhur ndonjëherë konflikte fetare. Madje shqiptarët për shekuj me radhë i kanë ruajtur kishat ortodokse në Kosovë e mjerisht objektet fetare islame në Kosovë por edhe në Serbi, nuk patën të njejtin fat. Beogradi në kohën e Perandorisë Osmane kishte afër 85 xhami, mesxhide, mejtepe e medrese, e sot ka vetëm 1 xhami. Poashtu vlenë të përmendim se gjatë luftës së fundit në Kosovë, gjatë periudhës 28 shkurt 1998-20 qershor 1999, nga soldateska serbe u dogjën, u granatuan dhe u shkatërruan 218 xhami, disa prej të cilave me vlera të mëdha arkitektonike.

Përfundim

Edhepse ne jemi të mendimit se konflikti serbo-shqiptar në Kosovë nuk kishte karakter fetar, pala serbe është përpjekur që simbolet fetare t'i përdorte për mobilizimin e forcave serbe për pastrimin e teritoreve ku jetojnë shqiptarët dhe për zhdukjen e monumenteve kulturore dhe historike të tyre, siç janë xhamitë, minaret, mejtepet si dhe vizatimi i katër S-ve si simbol i ortodoksizmit bile këtë në shumë raste e bënte policia serbe në krahërorët dhe fytyrat e të rinjve shqiptar. Njëkohësisht kisha ortodokse serbe i ka dhënë përkrhje të plotë regjimit të Milloshevicit, e që ka pasur rol të rëndësishëm në mobilizimin e segmenteve të caktuara antikomuniste të shoqërisë.

Me gjithë tërë ato që kanë ndodhur në Kosovë, por edhe në Maqedoni, qoftë në të kaluarën e largët apo të afërt, shqiptarët i janë kthyer ardhmërisë dhe ata jetësisht janë të interesuar për promovimin e vlerave të tolerancës,

mirëkuptimit dhe mbylljen njëherë e përgjithmonë të konflikteve qofshin ato ndërkonfesionale apo ndërnacionale.

Ndikimi ynë si njerëz të fesë dhe si lider fetarë, qoftë në Maqedoninë e Veriut apo në Republikën e Kosovës nuk mund të jetë vendimtarë, mirëpo as nuk duhet të nënqmohet. Liderët fetarë të të gjitha feve duhet të angazhohen për një bashkjetesë më të mirë. Ky është obligim i yni si njerëz të fesë sepse për këtë na obligojnë librat tanë të shenjtë, të cilat i lexojmë për çdo ditë. Nese i përmbahemi parimeve të pastërta të feve monoteiste dhe i shiqojmë në këtë prizmë, atëherë edhe pikat e përbashkëta ndërmjet hebreizmit, krishterimit dhe islamit do të ishin më të mëdha. Në këtë rast do të nxirrej përfundimi se keqkuptimet dhe konfliktet kanë ardhur nga interpretimet e shtrembëruara, nga devijimet që u janë bërë shpalljeve e jo nga shpalljet burimore dhe nga pejgamberët e pasuesit e tyre të vërtetë.

Misioni i udhëheqësve fetarë, i institucioneve fetare, akademike dhe shkencore është që midis njerëzve të kultivojnë dashurinë dhe respektin e ndërsjellë e të luftojnë urrejtjen e armiqsinë. Pra, të bëjmë diçka që si Maqedonia ashtu edhe Kosova të bëhen oazë e paqes dhe e bashkjetesës midis popujve që jetojnë në to. Në jemi të vetëdijshëm se ndërtimi i “paqës në shoqëritë multietnike nuk është i lehtë sepse ende ekzistojnë pengesa të ndryshme si e kaluara e hidhur, pushtimi njëshekullor, lufta, viktimat, të pagjeturit si dhe njërin ndër faktorët kryesor e që është nacionalizmi. Nacionalizmi etnik është njëra ndër sfidat më kryesore në eleminimin e ndasive ndëretnike dhe ndërfetare. Mirëpo përpjekjet nuk duhet të ndalen në konsolidimin e bashkejetesës, paqës dhe të tolerancës.

Bashkësia Islame e Kosovës, institucionet e saja edukativo-arsimore dhe ato akademiko-shkencore islame, kanë qenë dhe jenë të gatshëm që të bashkpunojnë me të gjitha komunitetet fetare në Kosovë dhe në Maqedoni për avansimin më tej të mirëqenies së përgjithshme, pavarësisht përkatësisë fetare, nacionale apo kulturore. Këtë e kemi treguar edhe në të kaluarën veçmas me komunitetin katolik shqiptar në Kosovë.

Literatura e Konsulltuar

1. Dahel A Robert, "Politiarkia",Tiranë, 2005.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.
3. Midgard Knut,Rasch Erik Bjorn, "Demokracia kushtet dhe pasojat" , Prishtinë , 2008 .
4. "Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhevlerat që islami përcjellë në këtë integrim" (Simpozium ndërkombëtar), Forumi Musliman i Shqipërisë, Kavajë, shkurt 2008.
5. Xhimi Karter, "Vlerat tona të rrezikuara. Kriza morale e Amerikës" (Jimmy Carter, "Our endangered values. America's moral crisis"), 2005 .
6. Fred Hollidei, " Islami dhe miti i konfrontimit…", 1996.
7. Mr. Qemajl Morina, Edukata Islame,(Revistë shkencore kulturore islame), nr. 84, Prishtinë, 2007 .
8. Rime Magazine, 17. 09. 2001, " The true peaceful face of islam" .
9. Bashkësia Islame e Kosovës, "Barbaria sërbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt-1998 – qershor 1999"), Prishtinë,2000 .

ROLI I GJUHËS NË SHOQËRINË MULTIKONFESIONALE

Muhamed MUSTAFI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup, e-mail: muhamed.mustafa@fshi.edu.mk

Abstrakt

Gjuha ka rëndësi të posaçme në të gjitha sferat e komunikimit dhe asgjë nuk mund të funksionojë pa përdorimin e saj, përndryshe, do të ishim memecë dhe do te duhej pantomime, që të kuptohemi në jetë.

Si në çdo fushë, ashtu edhe në fushën shoqërore, gjuha luan një rol të rëndësishëm për të patur mirëkuptim dhe mirëqenie ndërnjerëzore. Fenomenet shoqërore janë të ndryshme dhe brendia e tyre dallohet me koncepte multinacionale dhe mutikonfesionale, të cilat funksionojnë në bazë të gjuhës së përdorur për komunikim dhe bashkëpunim. Mënyra e funksionalizmit të gjuhës përcakton bashkëjetesën apo përçarjen dhe urrejtjen ndërkonfesionale shoqërore.

Urtësia e fjalëve dhe botëkuptimeve ndikon në formimin e një mirëkuptimit dhe tolerance ndërkonfesionale. Gjuha e matur, që përdoret ne shoqërinë e tillë, mundëson tejkalimin e morsmarrëveshjeve aktuale dhe mbizotërimin e paqës dhe tolerancës shoqërore.

Pra, nëse gjuha përdoret me mençuri dhe urtësi, atëherë garantohet roli dhe ndikimi konstruktiv i saj në harmoninë shoqërore ndërkonfesionale.

Fjalët kyçe: *Guha, roli, ndikimi, shoqëria, multikonfesionalizmi.*

Hyrje

Hapja hermeneutike nuk është grumbullim i njohurive për një traditë tjetër; Unë mendoj se një gjë e tillë është më tepër një qëndrim për të marrë pjesë tek tjetri në mënyrë që të kapërcejmë pretendimet e përgjithshme, plituditat

dhe stereotipet. Ndokush duhet të mësojë të përmbahet nga gjykimet tepër të nxituara. Sfidë është të flasim për dhe me tjetrin me nuanca, finesa dhe ndjeshmëri, dhe kjo kërkon t'i kushtojmë vëmendje gjuhës fetare të përdorur nga tjetri (p.sh., shamia e kokës nuk është një copë leckë, dhe rrethprerja nuk është pagëzim për hebrenjtë). Këtu kemi për qëllim diskutimin rreth ndjeshmërisë së çështjeve fetare, pasi ato ndërthurren fort me përvojat, narrativat dhe besnikërinë personale dhe shoqërore.

Gjuha e shoqërisë ndërkonfesionale

Mbi bazën e këtyre njohjeve, unë do të dëshiroja të propozoj një model disi më të madh të hermeneutikës ndërfetare, që pranon format gjithnjë ekzistuese dhe komplekse njerëzore të ndërveprimit komunikues, dhe që i koncepton ato në aspektin e hermeneutikës së dashurisë. Kështu, unë nuk dua të kufizoj hermeneutikën ndërfetare vetëm në dialogun midis traditave të përcaktuara, por do të marr këtë reflektim më tej në drejtim të një eksplorimi më radikal filozofik të mundësive njerëzore të takimit të vetvetes dhe të tjera. [1]

Njerëzit janë të prekshëm në lidhjet e tyre fetare dhe reagimet dhe veprat hakmarrëse mund të përjetohen thellësisht të dhimbshme. Kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë për një mençuri praktike, që do të na lejojë të lundrojmë në botën tonë fetare dhe të arrijmë tek të tjerët. Askush nuk mund të mësojë këtë duke e mbajtur "ndryshimin" në distancë të shkurtë. Të mësuarit në afërsi me të tjerët mundëson një ndryshim të perspektivës së nevojshme për t'u lidhur me të tjerët në një mënyrë të arsyeshme. [2]

[1] Catherine Cornille and Christopher Cornway, Interreligious hermeneutics, Cascade books, Eugene, Oregon, USA, 2010., f. 51.

[2] Marianne Moyaert, On the Role of Ritual in Interfaith Education, Religious Education, The official Journal of the Religious Education Association, Routledge, Issue 1 Vol 113, 2018, f. 49-60.

Udhëtimi në bisedë ndërfetare nuk është ndryshe nga një udhëtim nëpër botë ngase menjëherë vërejmë se jemi të lidhur me kultura, zakone dhe koncepte të ndryshme. Ashtu siç kur vizitojmë tokat e largëta, ne mund të marrim një libër frazash për të mësuar se si të lehtësojmë komunikimin bazë, bile edhe një libër me fraza të thjeshta për biseda ndërfetare mund të jetë i dobishëm. Më poshtë vijojnë disa sqarime, që nuk janë më shumë se një fjalor i fjalëve ndërfetare, si dhe prezenton një kapitull të mundshëm të një libri, që elaboron gjuhën dhe shprehjet e shoqërisë ndërkonfesionale..

Gjuha e shoqërisë multikonfesionale dhe multikulturore karakterizohet me tiparet vijuese:

a. Fjalori i perpiktë

Një pjesë e gjuhës ndërfetare është fjalori i përpiktë. Një kishë nuk është një sinagogë, një sinagogë nuk është një xhami (xhami) dhe një xhuxh nuk është një gurdwara (Sikaja e adhurimit të Sikhut). Përdorimi i termit të saktë tregon që ju keni marrë kohën për t'u bërë, të paktën, në thelb, të vetëdijshëm për traditën e besimit të partnerit të bisedës. Por, gjuha ndërfetare mund të jetë shumë konfuze. Ndoshta në vend të kushteve specifike për besimin, termet neutrale të besimit mund t'i shërbejnë më mire, për shembull, "shtëpia e adhurimit" është një term që përshtatet me shumicën e traditave dhe komunikon me ato që keni ndërmend të thoni pa e quajtur një mollë, një portokall për shkak se disa tradita të tilla, si shpirtërore amtare ose Baha'ite, nuk kanë domosdoshmërisht një "shtëpi" tradicionale të adhurimit, termi "vend i adhurimit" mund të jetë edhe më i përshtatshëm. Zhvillimi i një lloji të fjalorit ndërfetar joformal, të gjithanshëm, është një ushtrim i dobishëm, që rritë një vetëdije për fjalët, që ne përdorim, si dhe përhapë supozimin se "të gjithë janë ashtu si unë"

b. Respekti i ndërgjegjshëm

Një sugjerim i dytë për bisedë ndërfetare është gjuha e respektit të ndërgjegjshëm. Të mësosh përshëndetje të thjeshta është një shprehje respekti dhe nderimi për traditën dhe kulturën e tjetrit. Si shembull konkret

mund të theksojmë shprehjet: “Namaste (Hinduizëm), Shalom (Judaizëm), Assalaam Alajkum (Islam), Sat Sri Akaal (Sikhizëm)”. Ne do të gjejmë përshëndetje të ndryshme interesante për t'u mësuar dhe për t'u përdorur. Respekti i ndërgjegjshëm në bisedën ndërfetare nuk ka të bëjë vetëm me ate, që mund të dëshirojmë të themi, por edhe për ate, që mund të mos e themi. Shmangia e termave fyese ose gjykuese kërkon gjuhën e respektit të ndërgjegjshëm. Në vend që t'i referohemi një rituali ose ngjarjeje të veçantë si "të çuditshme", ne mund të përdorim terma si "të panjohur për mua" ose "të ndryshme nga sa kam parë unë më parë". Përdorimi i gjuhës së respektit tregon një ndjenjë dinjiteti dhe vlerë ndaj partnerit në dialog...

c. Gjuha autentike

Një sugjerim i tretë për bisedë ndërfetare është përdorimi i ndërgjegjshëm i gjuhës së brendshme / të jashtme. Tradicionalisht dihet se çdo besim ka leksikun e vet. Sikët e dinë mirë se çfarë nënkuptohet me termin “kangha”, muslimanët e kuptojne fjalën “dinë”, budistët e dinë “tanha” dhe hebrenjtë e dinë fjalen “aliyah”. Sidoqoftë, secili besim mund të jetë i panjohur në gjuhën e të tjerëve. Në mënyrë që të kuptohen bisedat ndërfetare, do të na ndihmonte të kemi mendjen se po flasim me një "të huaj", i cili mund të mos e njohë fjalorin e besimit tonë. Përdorimi i nocioneve të drejtpërdrejta të jashtme, si psh. "krehër i vogël prej druri" (kangha), "larje rituale" (wudu), "lakmi egoiste" (tanha) dhe "duke shkuar për të lexuar Tevratin" (aliyah), do të siguronte faktin se ne mund të kuptojmë edhe më shumë.

ç. Angazhimi i butë

Një sugjerim i katërt për gjuhën ndërfetare është angazhimi i butë i mendjes. Biseda ndërfetare nuk do të thotë të fshehësh besimet. Në të vërtetë, biseda më e mirë ndërfetare është ajo që zhvillohet me angazhime të sinqerta. Shpesh ndodhë që përmes angazhimeve të përbashkëta të partnerëve për dialog, besimet reciprokisht përmirësohen dhe pasurohen. Një ndarje e tillë mund të bëhet, bile edhe duhet të bëhet, me gjuhën e butësisë, që nuk është ekskluzive, arrogante apo mbrojtëse. Kur një çifut shpall se mesia ende nuk ka ardhur, një i krishterë nuk do të pajtohet; kur

një i krishterë shpall se Jezusi është Krishti, një musliman nuk do të pajtohet dhe kur një musliman shpall se Muhamedi a.s. është vula e profetëve, një Mormon nuk do të pajtohet...

Gjuha e bisedës ndërfetare na bën të jemi të ndërgjegjshëm dhe të kuptojmë se angazhimet tona nuk janë edhe angazhimet e të tjerëve. Ne ndajmë angazhime në mënyrë që të kuptojmë njëri-tjetrin, jo se mund ta bindim ose konvertojmë njëri-tjetrin. Ndoshta dy fjalë të dobishme për të shtuar në librin tonë të frazave ndërfetare janë: "për mua". "Për mua, Mesia ende nuk ka ardhur", ose "për mua Jezusi nuk është Krishti" dhe "për mua, Muhamedi është vula e pejgamberëve". Gjuha e angazhimit të butë në ndarjen ndërfetare qartëson bindjet tona dhe të njerëzve tjerë.

Gjuha ndërfetare, si çdo gjuhë tjetër, përfshinë të folurit dhe të kuptuarit. Një gjuhë më me mend është vetëm një nga shumë mjetet, për ta bërë të mundur një gjë të tillë. Nëse përfshihemi në biseda ndërfetare, pa dyshim, që do të mendojmë për shumë tituj të kapitujve të një libri frazash të gjuhës ndërfetare. Një gjuhë e tillë shpreh njerëzimin tonë të përbashkët, promovon qytetërimin dhe ndërton marrëdhënie me respekt dhe besim të ndërsjellë. Një gjuhë e tillë ndjek paqën.[1]

Orvajtja për të kuptuar Zotin te tjetri, hap shtigjet drejt një gjuhe të përbashkët ligjërimi, që na lejon të marrim pjesë në bisedë, të krijojmë partneritet dhe të mos pajtohemi me zell dhe bindje. Për ta bërë këtë, ne hudhim poshtë dikotomitë e vërteta - false ose i rivendosim ato në vend që të respektojnë rrëfimet e njëri-tjetrit. Madje, narrativat bllokojnë edhe pretendimet teologjike.[2]

[1] Larry (J.W.) Windland, The Language of interfaith conversation, Mindful interfaith language expresses our common humanity, builds relationships of respect and trust, and pursues peace, June 2007, www.100scarboromissions.com

[2] Catherine Cornille, Criteria of discernment in interreligious dialogue, Cascade books, Eugene, Oregon. USA, 2009, p. 44

Kërkimi ndërkonfesional dhe realiteti

Kërkimi fetar kërkon të orientojë tërë personin - mendjen, zemrën dhe trupin - në një botë reale. Kërkimi fetar nuk është thjesht konceptual por është trupor dhe efektiv. Personat fetarë dhe komunitetet kërkojnë një komplet autentik ekzistencial, që ndërlidhet me realitetin dhe me interpretimin e drejtë. Një orientim i tillë kërkon që bashkësitë fetare të zhvillojnë skema interpretuese dhe të ndërmarrin një regjim terapeutik duke u mbështetur në elementët e ndryshme të repertorit të një tradite. Asnjë traditë nuk është një skemë interpretuese. Tradita përmban skema të shumta interpretuese, të cilat kërkojnë të ofrojnë një lexim të reales për hir të orientimit të duhur. Por asnjë skemë interpretuese nuk realizon orientimin e duhur sepse orientimi në kuptimin fetar është çështje edhe e kompromitimit. Orientimi gjithëpërfshirës cilësor bëhet vetëm kur skemat interpretuese i gjejmë të instaluara në zemër, mendje dhe trup, me anë të disiplinave të një regjimi të veçantë terapeutik.

Skemat interpretuese gjenerohen nga tërheqja e një mori elementesh, si psh. mitet, simbolet, tregimet dhe kategoritë reflektuese të zhvilluara më qartë, madje edhe me sistemet metafizike. Regjimet terapeutike përfshijnë një mori disiplinash praktike, si psh. leximi dhe mësimi përmendësh i shkrimeve të shenjta, meditimi, performanca rituale, ikonolatria dhe të ngjashme. Të dyja janë të nevojshme për një orientim gjithëpërfshirës cilësor. [1]

Gjuha islame ndërkonfesionale

Koncepti islamik i dialogut është rezultat i procesit të përpiktë të të menduarit. Ajo nuk është formuar jashtë botës së frymëzimit hyjnor, por brenda, dhe kjo është arsyeja, që nuk mund të ekzistojë jashtë këtyre dimensioneve. 'Për njohësit e botëkuptimit islam, nuk është e vështirë të shihet se mendimi gjithmonë vlerësohet si përbërësi më i rëndësishëm i

[1] John J. Thatamanil, Transreligious Theology as the Quest for Interreligious Wisdom Defining, Defending, and Teaching Transreligious Theology, Open Theology, Vol.2, p. 354-362, De Gryiter open, Union Theological Seminary, New York, USA, f. 357.

jetës njerëzore dhe se duhet t'i kushtohet vëmendje asaj para çdo gjëje tjetër [1]

Parimi kryesor i gjuhës islame ndërkonfesionale dhe ndërkulturore mbështetet në ajetin kuranor:

"O njerëzim, me të vërtetë ju kemi krijuar nga mashkull dhe femër dhe ju kemi bërë popuj dhe fise që të njihni njëri-tjetrin. Në të vërtetë, më fisniku prej jush përpara Zotit, është më i drejti prej jush. Në të vërtetë, Allahu është i Njohur dhe i Njohur ". (Kur'ani, 49: 13)

Tema e dialogut vlerësohet si një nga temat më të rëndësishme në periudhën bashkëkohore siç ishte në të kaluarën dhe siç do të jetë edhe në të ardhmen sepse kjo çështje përcakton pozitën dhe vlerën e një kombi, kulture apo civilizimi gjatë intervaleve kohore dhe periudhave historike.

Çdo qytetërim karakterizohet me tipare specifike, që e lidhin njeriun me dialogun. Marrë parasyshë lidhjen e ndërsjellë, që përcakton vlerën e të drejtave të njeriut, si pjesë e shoqërisë njerëzore dhe qytetërimit, ne shohim se njeriu, që i përket një civilizimi, është në pozitë të mbrojë ndonjë civilizim të veçantë, pa emocione. Secili që jep pikëpamjet e veta për këtë temë, duhet të jetë larg iluzioneve dhe nuk duhet t'i përkasë botës, që ndihet superior ndaj vlerave të të tjerëve.

Kështu, vetëm nëpërmes kësaj metode mund të kuptohet se njeriu është objektiv gjatë shikimeve dhe analizave të tij për vlerat e dialogut.

Koncepti islam i dialogut është i përgjithshëm dhe vlerëson të gjitha fushat e jetës, si dhe nuk ofron asnjë grimcë të neglizhencës.

Qytetërimi islam i shërben dialogut njerëzor, dhe në këtë kontekst, Shejh Abdurrahman Habannaqa, thotë: "Përparimi i civilizimit është i ndarë në tre grupe:

a. Grupi i parë i shërben trupit dhe merret me çështje të jetës, shkaqet e kënaqësisë, bekimeve, dashurisë dhe epshit.

b. Grupi i dytë i shërben shoqërisë dhe merret me parimet e ekzistencës së sistemit, legjislacionit, ligjit, përhapjen e të mirave dhe bekimeve shoqërore.

[1] William C. Chittick, Science of the Cosmos, Science of the Soul, from English Edin Q. Lohja, Heart of tradition, Tirana, 2011, p. 69

c. Grupi i tretë ka të bëjë me individin dhe shoqërinë, përkatësisht, lumturinë e tyre si individë ose si shoqëri. Një lumturi e tillë është universale dhe e përjetshme sepse fillon nga momenti i vetëdijës njerëzore. " [1]

Ky 'parim i lëvizjes në strukturën e Islamit' [2] është një lëvizje fetare dhe ndërkulturore dhe nuk pranon asnjë koncept statik të dialogut sepse gjithçka është një organizëm i gjallë dhe ka një qëllim të përbashkët.

Sipas studiuesit të mirënjohur Mahmud Abbas Aqqad, njeriu mund të përmbushë kulturën në mënyrën më të mirë dhe në metodën më të përshtatshme pa u mbështetur vetëm në një burim të njohurive shkencore. Përveç fjalëve të Shejh Abdurrahman Habannaqa për përparimin e qytetërimit dhe burimit të civilizimit musliman, Aqqad flet në mënyrë të detajuar dhe thotë: "Ky civilizim i përsosur, i cili mbështetet në këtë mënyrë, është i përshtatshëm në çdo kohë, veçanërisht, në kohën tonë, e cila dallohet me skenë dhe ngjyra të ndryshme kulturore. Në këtë kohë ka një numër të madh të dhënash, dhe kush nuk mund të lexojë veprat madhore, mund të lexojë enciklopedi, dhe kush nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, ai mund të ndjek diskutimet dhe gazetat e lajmeve duke kërkuar sqarim.[3]

Ne duhet të pastrojmë shoqërinë tonë nga interpretimet e gabuara .. Asgjë nuk është individuale dhe përgjegjësia jonë duhet të jetë në favor të zhvillimit individual dhe shoqëror… Pra, asnjë civilizim nuk mund të formohet nëse pretendojmë ndarje midis ndjenjave të trupit, midis shkencës dhe edukimit, midis nevojave dhe shijes së trurit [4]

[1] Abdurrahman Habannaka, Usulul-hadaratil-islamijjeti wa wasailuha, edition 2, Darul-ilmi, Damascus-Beyrout, 1980, f.11.

[2] Muhamed Ikbal, Obnova vjerske misli u Islamu, Svjetlost, Sarajevo, 1979, f. 195

[3] Mahmoud Abbas Aqqad, Al-islam veil-hadaretul-insanijjetu, menshuratul-mekt ebetil-misrijjeti, Saida-Beirut, f. 171.

[4] Ibid, f. 176.

Përfundim

Gjuha luan rolin esencial në dialogun ndërkonfesional, ndërkulturor dhe ndërnacional, ngase përdorimi i kontrolluar i shprehjeve gjatë bisedës me të tjerët, zbutë bisedën dhe siguron mirëkuptimin e përbashkët. Metoda e tillë e përdorimit të gjuhës do të ndihmonte në tejkalimin e vështirësirave në jetën e përbashkët shoqërore.

Gjuha e ashpër shkakton huti, mosmarreveshje, grindje e luftëra në botë. Historia konfirmon se gjuha e urrejtjes ka mbjellur mostolerancë ndërfetare, ndërkulturore dhe ndërnacionale.

Nuk ka një popull apo një gjuhë por ka shumë popuj me shumë gjuhë, me shumë tradita, me shumë konfesione dhe me shume kultura. Një koncept i tillë i gjuhës nënkupton se do të kuptoheshim më mire sikur të kuptonim gjuhën e njëri tjetrit dhë sikur t'i njihnim vlerat ndërkonfesionale të njëri tjetrit.

Literatura

1. Abdurrahman Habannaka, Usulul-hadaratil-islamijjeti wa wasailuha, edition 2, Darul-ilmi, Damascus-Beyrout, 1980.
2. Catherine Cornille and Christopher Cornway, Interreligious hermeneutics, Cascade books, Eugene, Oregon, USA, 2010.
3. John J. Thatamanil, Transreligious Theology as the Quest for Interreligious Wisdom Defining, Defending, and Teaching Transreligious Theology, Open Theology, Vol.2, p. 354-362, De Gryiter open, Union Theological Seminary, New York, USA.
4. Larry (J.W.) Windland, The Language of interfaith conversation, Mindful interfaith language expresses our common humanity, builds relationships of respect and trust, and pursues peace, June 2007, www.100scarboromissions.com
5. Marianne Moyaert, On the Role of Ritual in Interfaith Education, Religious Education, The official Journal of the Religious Education Association, Routledge, Issue 1 Vol 113, 2018, P. 49-60.

6. Mahmoud Abbas Aqqad, Al-islam veil-hadaretul-insanijjetu, menshuratul-mekt ebetil-misrijjeti, Saida-Beirut.
7. Muhamed Ikbal, Obnova vjerske misli u Islamu, Svjetlost, Sarajevo, 1979, f. 195
8. William C. Chittick, Science of the Cosmos, Science of the Soul, from English Edin Q. Lohja, Heart of tradition, Tirana, 2011.

MULTIKONFESIONALIZMI NË SHOQËRINË MULTIETNIKE NË RMV

Shaban SULEJMANI
Fakulty of Islamic Scientice – Skopje, e-mail: shaban.sulejmani@fshi.edu.mk

Abstrakt

Multikonfesionalizmi sot është një koncept pothuajse i pranuar në shoqëritë sekulare. Ajo përfshin pjesëmarrjen e barabartë të feve në jetën publike, ku ato kontribuojnë në humanizimin e marrëdhënieve njerëzore. Në Ballkan, e posaçërisht në Maqedoni, nuk mund të flitet për monizëm fetar, sepse multikonfesionalizmi ka qenë një traditë e trashëguar ndër vite që nga koha e sundimit otoman në këtë zonë.

Sot nuk mund të flasim për një shtet, një fe dhe një komb. Ky koncept është tejkaluar për shkak të realitetit të vërtetë multietnik dhe shumë konfesional që hasim. Ajo gjithashtu duhet të diktojë diskursin e një realiteti të tillë i cili nuk mund të vehet në masë të një niveli vetëm të projeksionit mendorë ose të një matricë ideologjike të pavarur nga ai realitet.

Fjalë kyçe: *multikonfesionalizmi, shoqëri sekulare, fe, komcept dhe multietnike*

Multikonfesionalizmi në shoqërinë multietnike në RMV

Pozita e fesë në shoqëritë multietnike në shekullin XXI është akoma e rëndësishme, megjithëse ka pasur parashikime se do të vijë fundi i "botës"[1]. Feja po lufton për rolin e saj në jetën publike në mënyrë që të ndihmojë njeriun modern. Besohet gjerësisht se feja nuk mund të jetë pasive përballë fatit të njeriut modern. Sidoqoftë, nuk mund të presim pjesëmarrjen e fesë në jetën publike në shumicën e sferave të saj, por mund të luajë një rol të rëndësishëm në humanizimin e kushteve tashmë të vendosura të një shoqërie multietnike, siç janë të gjitha shoqëritë në Ballkan. Pjesëmarrja në një fe të veçantë nuk duhet të nënkuptojë një ide apo kornizë që përfshin përzierjen ose ideologjizimin e burimeve shoqërore për qëllimet e veta ekskluzive, sepse ligjërimi modern sekularist që rregullon marrëdhëniet shtet-fe nuk e lejon atë. Kjo nuk do të thotë që feja duhet të mbulojë të gjithë sistemin arsimor, për shembull, por ta trajtojë atë si një nga komponentët e jetës shoqërore.

Feja si një e vërtetë historike shumëvjeçare (e përjetshme) është një histori më e gjatë sepse ajo daton që kur dihej për njeriun[2]. Ajo gjithmonë i ka rezistuar sfidave me të cilat përballet, sepse ajo ka një strukturë të tillë vlerash që asgjë nuk mund të „ngulfatet“[3]. Ajo nuk u „ngulfat“ as nga kombi, që doli si alternativë e tij në shekujt 18 dhe 19, as dhe nga sistemet totalitare që i shpallën luftë fesë; po as këtë mund ta realizohoj sekularizimi, që vjen nga globalizimi dhe „demokracia“ që sot po mbrohet si „fe“ sekulare.

Feja bazohet në faktorët e saj të brendshëm që kanë një rëndësi të konsiderueshme ekzistenciale për njeriun dhe për dhe për komunitetet

[1] Shih artikullin e Amdreja Scen dhe Monika Bogeljiç, “Multikulturalizam u Europi danas-novi rascjepi granica identiteta i prava”, fq. 103-18, publikuar në ///C:/Users/ASUS/Downloads/6_A_Srsen.pdf, vizituar me datë 19.07.2020.
[2] Shih Douglas J. Davies and Michael J. Thate (eds.), *Religion and the Individual: Belief, Practice, and Identity*, editorialin me titull “Religion, identity and Belief”, Fisrt edition, MDPI, Basel & Switzerland 2017, fq. 1-4.
[3] Abdul Baki Ibrahim, *Tesil el-kijem el-hadarije fi benail medinetil islamijetil muasire*, Merkez ed-dirasat el-ikhtitije vel mimarije, Kairo 1982.

(shoqëritë) në përgjithësi[1]. Migjithatë, feja sot operon në një atmosferë laike/sekulare dhe, së bashku me aktorët e tjerë shoqërorë, po lufton për pozicionin e saj.

Sidoqoftë, sot nuk mund të flasim për homogjenizimin fetar dhe kombëtar[2]. Është e pamundur kjo, sepse nuk ka asnjë komunitet në Ballkan që nuk ndërthuret me anëtarët e shumë traditave fetare. Realiteti multikonfesional përjashton çdo lloj ekskluzivizmi apo sundimi fetar, pavarësisht nga numri i ndjekësve të një feje të veçantë. Kjo është arsyeja pse ideja e pluralizmit fetar ose multi-konfesionalizmit po promovohet në të gjithë botën. Asnjëherë nuk është folur më shumë, qoftë tek intelektualët e krishterë apo tek ata islamikë, për pluralizmin fetar siç bëhet sot.

Mult-konfesionalizmi në Ballkan është rezultat i multietnicitetit të shoqërive të Ballkanit. Ky multi-konfesionalizëm, mund të themi lirshëm, bazohet në traditat dhe praktikat permanente fetare ballkanike. Ai ndryshon shumë nga multikonfesionalismi në disa vende të Evropës Perëndimore. Në këto vende, multi-konfesionalizmi bazohet në thelb në lëvizjet e migracionit, duke filluar nga fundi i shekullit të 19-të dhe përgjatë shekullit të 20-të.

Sa i përket multi-konfesionalizmit në Ballkan, është një ide autentike që nuk është datuar për një kohë të gjatë. Multikonfesionalizmi brenda Perandorisë Osmane ishte baza mbi të cilën gjithçka quhej "sistemi i miletit", ku njerëzit numëroheshin ose regjistroheshin sipas përkatësisë së tyre fetare[3]. Kjo përfshin faktin se pluralizmi fetar ishte, në një farë mënyre, një detyrim shtetëror që rrallë haset në pjesë të tjera të botës. Në këtë perandori gjejmë territore shumë konfesionale dhe multietnike. Është e

[1] Efekti i saj është i gjithanshëm kur feja drejt dhe sakt prezantohet, siç mund të shieht nga publikimi i bërë me rastin hulumtimit të bërë nga disa studijues në lidhje me disa dukuri shqetësuese sot në shoqërinë tonë, shih E. Morina, Beatrix Austin dhe të tjerë (edit.) *Perspektiva Komunitare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm-raport hulumtimi*, Beghof Foundation, publikuar në https://www.berghoffoundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CommunityPerspectivesViolentEx tremismCompReport_2019-alb.pdf, vizituar me datë 19.07.2020.

[2] Shih Eliezer Ben-Rafael & Yitzhak Sternberg, *Worl Religions and Multiculturalism: A Dealectic Relation*, Brill, Lieden & Boston 2010.

[3] Shih Tanford J. Shaw, *Historia e Penadoriës Osmane dhe e Turqisë moderne*, vëll. 1, Jehona stady center, Tiranë 2006.

qartë se në Ballkan - megjithë përplasjet e shpeshta - asnjë etni nuk është shkatërruar ose shkatërruar plotësisht siç ishte rasti në disa pjesë të tjera të Evropës.

